



**PROJEKT RIKUALIFIKIMI NË ZONËN URBANE PRANË QENDRËS  
SË QYTETIT VLORË: HARTIM I PROJEKTIT URBAN, RESTAURIM I  
MONUMENTEVE TË KULTURËS NË KËTË ZONË DHE  
RIKONSTRUKSION I OBJEKTEVE TË TJERË**

**SPECIFIKIME TEKNIKE**

PROJEKT ZBATIM

**ZONA A+B**

## **PARAQITJE E PËRGJITHSHME**

Këto “Specifikime Teknike”, janë një dokument hartuar enkas nga ATELIER 4, për realizimin e projektit të: **“Projekt rikualifikimi në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë: hartim i projektit urban, restaurim i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstruksion i objekteve të tjera”**

Ky dokument të konsiderohet si pjesë përbërëse e Dokumentacionit të Projektit Zbatimit dhe Preventivit Përfundimtar për objektin e mësipërm.

Kapitujt dhe Zërat e radhitur në përbajtje të këtyre specifikimeve teknike janë pjesë dhe përshkrim i detajuar i vizatimeve të ATELIER 4, si dhe specifikime të tjera të mundshme të kategorive të ndryshme të punimeve ndërtimore.

Kontraktorët e Punimeve të Ndërtimit duhet t'u referohen specifikimeve teknike të atyre zërave të punimeve të cilat përfshihen në përshkrimet e Vizatimeve, në Preventivin Përfundimtar si dhe në Përshkrimin e Punimeve.

Standartet e përdorura në këto “Specifikime Teknike” dhe që do të aplikohen më tej nuk mbështeten vetëm në vizatimet, por edhe në manualet ligjore dhe libra të tjera këshillues si:

- Manuali Nr.1 i “Analizat Teknike Prodhimi i Materialeve të Ndërtimit”  
*Tiranë – 20.01.2010 (Republika e Shqipërisë - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave).*
  - Manual Nr.2 i “Analiza Teknike për Punimet e Ndërtimit të Ndërtesave”, *Tiranë – (Republika e Shqipërisë - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave, me vendim Nr.629, datw 15.7.2015).*
- 

### **LEGJENDA:**

**V.T.:** *Vizatime Teknike*

**P.P.:** *Përshkrimi i Punimeve*

**S.T.:** *Specifikime Teknike*

## **1. PROJEKTI ARKITEKTONIK – SPECIFIKIME TEKNIKE**

### **I. PRISHJE DHE HEQJE**

#### **1. Ngritje kantjeri, rrethim.**

Ngritje, mobilim dhe kompletim te zyrave me pajisje, mirembajtje, furnizim me tere komponentet e nevojshem dhe çmontim te zyrave te menaxhimit te kantierit. Keto zyra duhet te kene ambiente te mjaftueshme pune per kontraktorin, supervisorin + investitorin. F.V. Rrethim i objektit me ndarese teli me tubo + aksesoret prej betoni. Rrethimi do behet ne te gjithe zonen ku do te punohet, sipas plan organizimit te punimeve. Ne cmim perfshihet, F.V. e elementeve kufizues, menaxhimi i hyrje daljeve ne kantier, sigurimi i levizjes se kembesoreve gjate ndertimit, heqja ne perfundim te punimeve e rrethimit, pastrimi i zones ne perfundim te punimeve. Cdo demtim i rrethimit do te zevendesojet nga kontraktori pa kosto shtese. Gjate gjithe kohes se kryerjes se punime kontraktori obligohet qe te marr te gjitha masat per rregullimin e komunikacionit, sigurise ne kantier dhe sigurise se kembesoreve me sinjalistike rrugore fosforishente. Ne çmim perfshihen imazhe te tregut ne skela ne inagurimin e fillimit te punimeve dhe ne perfundim. Skelat do te jene te veshura me rrjete mbrojtese. Likuidimi: 50% do te perfitojet ne Situacionin nr. 1 dhe 50% ne Situacionin perfundimtar.

#### **2. Prishje objekte 1 kat tulle**

Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:

- Prishjen e pjesëshme e godinës ekzistuese, duke përdorur çdo mjet përfshirë
- puntelimet, skelën e shërbimit, marrjen e masave për aplikimin e të gjithë akteve përkatëse të sigurisë së mbrojtjes së punëtorëve dhe popullsisë
- sinjalet e ditës e të natës si dhe personelin për lajmërimin e kalimtarëve
- punimet për rrethimet e përkohshme
- riparimin për dëmet e mundshme që mund t'u shkaktohen të tretëve dhe riparimimi i tubacioneve publike dhe private
- ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin

#### **3. Heqje shtresë ekzistuese e tjegullave**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> çati në plan dhe përfshin:

- Heqjen e kujdeshme të tjegullave egzistuese
- Pastrimin e tyre nga llaçi dhe pluhurat
- Kontrollin për gjendjen e tyre (nëse mund të ripërdoren ose jo)
- Ruajtjen dhe magazinimin e tjegullave që do të ripërdoren
- Largimin nga kantieri i tjegullave që nuk do të ripërdoren
- Ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin

#### **4. Heqje dyer, dritare dhe vetrata**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Heqjen e tyre nga muratura të çdo lloji vetratë, dritareje ose dere, të çdo madhësie e materiali, me çdo mjet që do të jetë i nevojshëm. Në monumentet e kulturës heqja e dritareve do të bëhet e kujdeshme në mënyrë që lënda autentike në gjendje të mirë të mund të ripërdoret.
- Kontrollin e gjendjes së lëndës drusore, nëse mund të ripërdoret ose jo (vetëm për objektet monument kulture)
- Ruajtjen dhe magazinimin e lëndës që do të ripërdoren (vetëm për objektet monument kulture)
- Largimin nga kantieri i lëndës që nuk do të ripërdoren
- Ngarkimin e materialeve që rezultojnë nga prishja, përfshirë transportin dhe shkarkimin

## 5. Prishje mure tulle

Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:

- Prishjen e muraturës me tulla të çfarëdo lloji dhe dimensioni, edhe e suvatuar ose e veshur, që realizohet me çfarëdolloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie
- Vënien mënjanë dhe pastrimin e tullave për përdorim,
- Sistemimin brenda ambientit të kantierit
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

*Për objektet monument kulture ose objektet e vjetra të cilat do ti nënshtrohen procesit të restaurimit, punimet duhet të kryhen me kujdes dhe gjithmonë nën mbikëqyrjen e specialistit restaurator, për të zbuluar ndonjë element apo gjurmë të fazave më të hershme si dhe për të bërë dokumentimin e tyre.*

## 6. Prishje mur blloqe betoni

Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:

- Prishjen e muraturës me blloqe betoni të çfarëdo lloji dhe dimensioni, edhe e suvatuar ose e veshur, që realizohet me çfarëdolloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

## 7. Prishje soletë beton arme (dysheme, streha)

Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:

- Prishjen e soletave/dyshemeve/strehave të çdo lloj betoni të armuar: dimension, markë betoni si dhe shtresave të ndryshme që mund të ketë mbi të, që realizohet me çdo lloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie
- Prishjen e trarëve konsol, sekondarë ose kryesorë (sipas gjendjes faktike në vend për çdo objekt)
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

Procesi i prishjes së soletave duhet të ndjekë rigorozisht këtë metodologji dhe radhë pune:

- Do të fillojë në hapësirë në mes dhe të përparojë drejt trarëve mbështetës
- Trarët e katit do të shkatërrohen në rendin si më poshtë:
  - trarët konsol
  - trarët sekondarë
  - trarët kryesore.

*Në rastin kur stabiliteti strukturor i trarëve është cënuar, p.sh. për shkak të humbjes së lidhjeve, trarët e prekur do të shtyhen para humbjes së mbështetjes ose lidhjes.*

## 8. Prishje shkallë beton arme

Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:

- Prishjen e shkallëve të çdo lloj betoni të armuar: dimension, markë betoni si dhe shtresave të ndryshme që mund të ketë mbi to, që realizohet me çdo lloj mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

## 9. Prishje shtresa ekzistuese në oborre

Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:

- Prishjen e shtresave të pllakave të granilit të çdo dimioni ose mënyre montimi që mund të gjendet në vend; që realizohet me çdo lloj mjeti dhe e çfarëdo trashësie.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

*Prishja do të bëhet deri në nënshtresën aktuale, duke gjykuar në vend me restauratorin dhe mbikëqyrësin e punimeve nëse nënshtresa aktuale është e përshtatshme për shtresat e reja.*

## 10. Heqje parapete me balaustra b/a

Ky çmim jepet lek/ml dhe përfshin:

- Çmontimin e çdo lloj balaustre që gjendet në terren, të çdo lloj dimioni, më çfarëdo trashësi të brezit të betonit të vendosur sipër tyre.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

*Në rastet e monumenteve të kulturës çmontimi i tyre duhet të bëhet shumë i kujdësshëm në mënyrë që të mos dëmtojë materialin autentik në monument.*

## 11. Prishje dysheme druri

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për prishjen e çdo lloj dysheme druri (çdo lloj dimioni, konstruksioni, lënde drusore)

- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

*Kuota se deri ku do të çmontohet dyshemeja e drurit do të përcaktohet në terren, gjatë zbatimit të punimeve, në bashkëpunim me restauratorin dhe mbikëqyrësin e punimeve.*

*Në rastet e monumenteve të kulturës procesi i prishjes së dyshemesë së drurit duhet të ndjekë rigorozisht këtë metodologji dhe radhë pune:*

- Çmontimin e elementëve drusorë në mënyrë manuale dhe me shumë kujdes që të mos dëmtohet lënda drusore e ndërkatit ose struktura mbi të cilën është shtruar.
- Elementët e hequr do të inspektohen për shkallën e dëmtimit të tyre, nëse disa prej tyre janë të vlefshëm për tu ripërdorur ose jo.
- Magazinim i lëndës që do të ripërdoret

## 12. Prishje shkallë druri

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për prishjen e çdo lloj shkallësh druri (çdo lloj dimensioni, konstruksioni, lëndë drusore)
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

*Në rastet e monumenteve të kulturës procesi i prishjes së shkallëve së drurit duhet të ndjekë rigorozisht këtë metodologji dhe radhë pune:*

- Çmontimin e elementëve drusorë në mënyrë manuale dhe me shumë kujdes që të mos dëmtohet lënda drusore e strukturës
- Elementët e hequr do të inspektohen për shkallën e dëmtimit të tyre, nëse disa prej tyre janë të vlefshëm për tu ripërdorur ose jo
- Magazinim i lëndës që do të ripërdoret

## 13. Prishje suva në fasada

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për prishjen e çdo lloj shtrese suvaje (suva tradicionale, llaç gëlqere, llaç çimento, llaç i përzjerë, etj.) në çfarëdo lartësi dhe sipërfaqe murature (tulle, guri, betoni, etj.); që realizohet me çdo lloj mjeti.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

*Në rastet e monumenteve të kulturës procesi i prishjes së suvasë duhet të ndjekë rigorozisht këtë metodologji dhe radhë pune:*

- Vlerësimi i hollësishëm i gjendjes së konservimit nga specialisti restaurator, evidentimi i kufirit midis zonave ku do të ruhet suvaja autentike dhe zonat ku do të prishet (Ky

përcaktim bëhet mekanikisht duke bërë goditje të lehta me spatul mbi sipërfaqen e suvasë. Në zonat ku suvaja ka kriuar xhepa dhe është shkëputur nga sipërfaqja e murit, goditjet kanë tingull të ndryshëm nga ato në zonat me suva të padegraduar)

- Heqjen e kujdesëshme në mënyrë manuale të suvasë së degraduar
- Pastrimin me furçë teli të sipërfaqes së muraturës së zhveshur nga suvaja

#### **14. Heqje materiali të degraduar në dekore dhe parapete (pastrim mekanik me spatul dhe furçë teli)/heqje e plotë dekorë**

*Ky çmim jepet lek/ml dhe përfshin:*

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për heqjen e çdo lloj materiali të degraduar në çdo lloj dekor (realizuar me llaç gëlqere, suva llaç çimento, gurë të gdhendur etj.) në çfarëdo lartësi dhe sipërfaqe murature (tulle, guri, betoni, etj.); që realizohet me çdo lloj mjeti. (në rastet kur dekor i do të qëndrojë përsëri)
- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për heqjen e plotë të çdo lloj dekor (realizuar me llaç gëlqere, suva llaç çimento, gurë të gdhendur etj.) në çfarëdo lartësi dhe sipërfaqe murature (tulle, guri, betoni, etj.); që realizohet me çdo lloj mjeti. (në rastet kur dekor i do të hiqet plotësisht)
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

*Në rastet e monumenteve të kulturës procesi i heqjes së materialit të degraduar duhet të ndjekë rigorozisht këtë metodologji dhe radhë pune:*

- Vlerësimi i hollësishëm i gjendjes së konservimit nga specialisti restaurator, evidentimi i kufirit midis zonave ku materiali i dekorit paraqitet i degraduar (Ky përcaktim bëhet mekanikisht duke bërë goditje të lehta me spatul mbi sipërfaqen e dekorit. Në zonat ku materiali i dekorit është i degraduar, goditjet e spatulës e dëmtojnë atë fare lehtësisht)
- Heqjen e kujdesëshme në mënyrë manuale të materialit të degraduar, në mënyrë që të mos dëmtohet materiali i shëndoshë. Heqja mund të bëhet me daltë e çekiç ose spatul, në varësi të fortësisë së materialit me të cilin është realizuar dekor.
- Pastrimin me furçë teli të sipërfaqes ku ndodhej materiali i degraduar

#### **15. Heqje davanciale në dyer e dritare**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për heqjen e çdo davanciali të çdo lloj materiali (pllakë mermeri, graniti, betoni, etj.) në çfarëdo lartësi dhe që realizohet me çdo lloj mjeti.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

#### **16. Prishje e veshjeve të shkallëve me mermer**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për heqjen e çdo pllakë mermeri të çdo lloj dimensioni dhe në çfarëdo lartësi dhe që realizohet me çdo lloj mjeti.
- Në objektet monument kulture ky proces duhet bërë me kujdes që të mos dëmtohet materiali autentik nën veshjen e mermerit.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

#### **17. Prishje veshje me panele gips cimentato në fasada (Kulla e Sahatit)**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për heqjen e çdo paneli gips që vesh dhe tjetëron fasadën e Kullës së Sahatit. Të bëhet heqja e kudesshme e tyre si dhe konstruksionit metalik mbajtës së paneleve në mënyrë që mos dëmtohet muratura autentike e objektit.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

#### **18. Çmontim shkallë metalike + Strehë e mbuluar me fletë metalike**

Ky çmim jepet lek/kg dhe përfshin:

- Të gjitha proceset që duhen ndjekur për çmontimin e çdo konstruksioni metalik (shkallë metalike, streha me kosntruksion metalik, mbuluar me fletë metalike), të ço lloj dimensioni dhe lartësie si dhe që realizohet me çdo lloj mjeti.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia

#### **19. Çmontim dhe rimontim kondicionerësh në fasadë**

Ky çmim jepet lek/copë dhe përfshin:

- Çmontimi i kujdeshëm i kondicionerëve individualë në fasadat e objekteve, për të mos i dëmtuar në mënyrë që të rimontohen sërisht në përfundim të punimeve.
- Magazinimin e tyre në vende të sigurta për sa kohë do të zgjasin punimet.
- Transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimin e tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.


## **II. PUNIME RESTURIM/NDËRTIM ÇATIE**

Çmimet jepen lek/m<sup>2</sup> për çdo zë punimesh dhe përfshin tërësinë e punimeve:

Për ndërtim çati të re

- Ndërtim kapriata druri + mahi
- Shtresë Knaufi për tavan
- Membranë avullizoluese LDS 5 Silk
- Lesh Xhami t = 8 cm
- Shtresë termoizoluese lesh guri t = 6cm

- Shtresa dysheme dërrase t=2 cm (elementet e derrases te jene te distancuar nga njeri tjetri 1 cm)
- Listela horizontale dhe vertikale t=4cm çdo 33cm
- Lyerje me bitum kokat e trarëve që mbështeten në mure
- Shtresë mbulimi që sipas vizatimeve teknike mund të jetë me:
  - o me tjegulla qeramike në të cilën përfshihen edhe kulmoret (lloji I tjegullës jepet në fletët grafike të projektit)
  - o material corten në të cilën përfshihen:
    1. Fletët e hekurit të përpunuar amea cide + lyer me bojë elektrostatike pudër
    2. Struktura druri për montim
    3. Aksesorë
- Kasetë + varanka shkarkimi
- Aksesore plotesues
  - Membranë hidroizoluese dhe avullizoluese LDS 0,04
  - Shtresa ngjitëse doppio adesive LDS Solfit 2
  - Shtresa ngjitëse adesive LDS Solfit
  - Elemente knaufi për fiksimin e tavanit
  - Gozhdë
  - Ganxha



**Detaj i Ndertimit te catise**

### Për restaurim ose rikonstruksion çati ekzistuese

- F.V. tiranta me shufra ose pllaka çeliku dhe tirantat e çatisë (lek/ml, ratset kur do të përdoret ky zë, jepet në fletët grafike të projektit)
- Vendosje pllaka ose kunja çelik për tiranta (lek/copë, rastet kur do të përdoret ky zë, jepet në fletët grafike të projektit)
- F.V. breza antisizmik druri në nivel çatie h=10cm (lek/ml, ratset kur do të përdoret ky zë, jepet në fletët grafike të projektit)
- Plotësimi i konstruksionit të drurit të çatisë të degraduar, duke respektuar përmasat e konstruksionit të hequr dhe skemën tradicionale të çatisë. (Gjendja e elementeve të konstruksionit do të kontrollohet nga restauratori dhe mbikqyrësi i cili do të vendosë se cilët elementë do të ruhen dhe cilët jo). Elementët kryesorë konstruktivë (trarët) do të konsolidohen duke iu nënshtruar një trajtimi dezinfektues ndaj agjentëve atmosferikë dhe krimbave e kërpudhave me antimol e insekticid. Trarët në pjesën mbështetëse të murit do të lyhen më zift ose material kundër lagështirës, në të gjitha rastet trarët ndërmjet tyre, do të kafen me ganxha metalike
- Plotësimi i dyshemesë së drurit me petavra 2.5 \* 15÷20 cm (dru pishe i stazhionuar). Petavrat në gjendje të mirë do të ripërdoren dhe ato të degraduara do të largohen nga kantieri.
- Shtresë termoizoluese lesh guri t=6 cm (trashësia konkrete që do të përdoret në çdo objekt, jepet në fletët grafike të projektit)
- Membranë hidroizoluese dhe avullizoluese LDS 004 ose Shtresë hidroizoluese t=4mm (shtresa hidroizoluese e çatisë do të përzgjidhet në konsultë me mbikqyrësin e punimeve në mënyrë që të përshtatet me kushtet specifike që kërkon çatija e vendit). Hidroizolimi të realizohet me mbivendosje të shtresave (minimumi prej 12 cm) dhe të ngrihet në drejtimin vertikal në muret anësorë me min. 10 cm.
- Shtresa ngjitëse doppio adhesive LDS Solfit 2
- Listela horizontale + Vertikale t = 4 cm.
- Vendosja e tjegullave duke përdorur tjegullat ekzistuese të cilat nuk janë të thyera dhe të përshkueshme nga uji. Tjegullat do të provohen me trokitje, nëse tingulli është i pastër dhe i qartë ato janë në gjendje të mirë. Tjegullat që do të ripërdoren duhet të lahen me furçë teli dhe ujë. Furnizimi dhe vendosje e tjegullave të reja të cilat duhet të janë të ngjashme dhe me të njëjtat dimensione me ekzistueset mund të bëhet me tjegulla të përdorura që blihen në zonat përreth pasi ato kanë edhe ngjyrën si ato që janë në vepër, apo në mungesë tregu do të prodhohen enkas. Dy rrjeshtave të para në krye, do tu bëhet një mbushje e kujdesëshme me llaç gëlgjere me pluhur tulle (i padukshëm nga jashtë) për të realizuar një qëndrueshmëri ndaj erës dhe agjentëve atmosferikë.

Në të dy rastet e punimeve në çati (ndërtim apo restaurim) lënda e re e drurit e cila do të përdoret do të jetë dru pishe e stazhionuar mirë dhe e cilësisë së lartë, me karakteristika:

- Lagështi jo më tepër së 12 %,
- Peshë volumore 410 – 540 Kg/m<sup>3</sup>,
- Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa
- E trajtuar me material resistent ndaj agjentëve atmosferikë, antimolë e insekticid si dhe dy duar vaj lini.

### **III. PUNIME TARRACE**

*Çmimet jepen për çdo zë punimesh dhe përfshin tërësinë e punimeve të pregetitjen e tyre në kantier, vendosjen në vepër si dhe të gjitha makineritë që janë të nevojshme për këto punime:*

- Shtresë llüstër çimento 1:2
- Shtresë Avullizoluese me barrierë alumini
- Shtresë ngjitëse
- Shtresë termoizoluese lesh guri t=12cm, e lesh guri 175 kg/m<sup>3</sup>
- Shtresë mbrojtëse gjeotekstil
- Shtresë ngjitëse
- Shtresë hidroizoluese t=5mm, + aksesorë të fiksimit dhe pafta plastike sipas Vizatimeve Teknike
- Pafta plastike
- Plakë betoni 20 x 20 x 5 cm
- Suvatim Parapeti nga brenda
- Kasetë + varanka shkarkimi
- Veshje kornizë parapeti me llamarinë xingat + impluve

*Të konsultohen fletët grafike të projektit për çdo hollësi që duhet aplikuar në secilin objekt.*

#### **20. Brez betoni C-12/16**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, pregetitjen në kantier dhe vendosjen e betonit në vepër*

- Shtresë betoni markë C-12/16, me t= 10cm, i hedhur në vepër mbi shtresa ekzistuese të verandës dhe i formuar nga shtresa të holla të vibrues mirë, duke përfshirë çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë të rregullt.
- çdo gjë tjetër të nevojshme për përfundimin e punës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte

#### **21. Suvatim parapeti nga brenda**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, pregetitjen në kantier dhe aplikimin e suvasë në vepër*

- Sprucim i sipërfaqes së muraturës së parapetit

- Aplikim llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund sprucimit.
- Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m<sup>2</sup>: rërë e larë 0,005 m<sup>3</sup>, llaç bastard (m-1:2) 0.03 m<sup>3</sup>, çimento (m-400) 6.6 kg, ujë, e aplikuar, në bazë të udhëzimeve të përgatitura, në mure e tavane, dhe e lëmuar me mistri e bërdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

#### **IV. PUNIME MURATURE**

**Llaç për muret për 1 m<sup>3</sup> llaç realizohet me këto përbërje:**

- Llaç bastard me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% dhe porozitet 40 % e formuar me rërë në raporte 1: 0, 8 : 8. Gëlqere e shtuar në 110 lt, çimento 300, 150 kg, rërë 1.29 m<sup>3</sup> .
- Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% me çimento: gëlqere: rërë në raporte 1: 0,5: 5,5. Gëlqere e shuar 92 lt, çimento 300, 212 kg, rërë 1,22 m<sup>3</sup> .
- Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gëlqere, rërë në raport 1: 0,8: 8. Gëlqere e shuar 105 lt, çimento 300, 144 kg, rërë 1,03 m<sup>3</sup> .
- Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento: gëlqere, rërë në raport 1: 0,5:5,5. Gëlqere e shuar 87 lt, çimento 300, 206 kg, rërë 1,01 m<sup>3</sup> .
- Llaç çimento marka 1:2 me rërë të larë e formuar me çimento, rërë në raport 1:2. Çimento 400, 527 kg, rërë 0,89 m<sup>3</sup>.

Tulla si element i ndërtimit duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme për ndërtimet antisizmike:

Rezistencën në shtypje, e cila duhet të jetë: për tullën e plotë 75 kg/cm<sup>2</sup>

#### **Markat e betonit**

Raportet e mëposhtme për betonin, përdorur në punimet e ndërtimit dhe referuar zërave specifike, janë të vleshme për 1(një) m<sup>3</sup> volum beton me çimento të zakonshme Portland. Këto standarte bazohen në broshuren "Projektimi i Betoneve të Zakonshme, K.T. 37-75", datë Tiranë - 1980 (Republika e Shqipërisë - Ministria e Ndërtimeve I.S.P.Nr. 1).

- Beton marka C-7/10 me zhavorr natyror:  
Çimento 300 kg 240 , zhavorr m<sup>3</sup> 1,05 , ujë m<sup>3</sup> 0,19.
- Beton marka C-10/12 me inerte, konsistencë 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e larë me modul 2,6:  
Çimento 300 kg 240 , rërë e larë m<sup>3</sup> 0,45 , granil m<sup>3</sup> 0,70 , ujë m<sup>3</sup> 0,18.

- Beton marka C-12/15 me inerte , konsistencë 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e larë me modul 2,6:

Çimento 400 kg 260 , rërë e larë  $m^3$  0,44 , granil  $m^3$  0,70, ujë  $m^3$  0,18.

- Beton marka C-25/30 me inerte, konsistencë 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e larë me modul 2,6:

Çimento 400 kg 370 , rërë e larë  $m^3$  0,43, granil  $m^3$  0,69 , ujë  $m^3$  0,185.

Për betonin marka 300, do të përdoret Çimento antisulfate sipas projektit konstruktiv shih V.T.

## **22. Mure tulle t= 20cm / 25cm dhe 38 cm**

*Ky çmim jepet lek/ $m^3$ dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, prebatitjen në kantier të llaçit dhe ndërtimin e muraturës*

Muraturë me tulla të plota mbajtëse në lartësi deri 3 m, realizohet më llaç bastard m-25, sipas përshkrimit në paragrafin më sipër, me përbajtje përmes:

- tulla të plota nr. 404,
- llaç bastard m3 0.25,
- çimento 400,

Për çdo trashësi muri, duke përfshirë çdo detaj dhe kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, parmakët, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo gjë tjeter të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte. Në katin përdhe, muratura e tullës do të ndërtohet mbi një shtresë bitumi me trashësi minimale 3 mm. Dy shtresa me bitum likuid të nxehtë pranohen.

## **23. Restaurim mur guri/tulle me llaç gëlqere me teknikën shqep-qep**

*Ky çmim jepet lek/ $m^3$ dhe përfshin*

- Prishjen e suvatimit ekzistues duke nxjerrë muraturën në pah.
- Heqjen e elementeve të muraturës të prekura nga çarja dhe disa elementeve të tjera, deri në formimin e një hapësire të mjaftueshme përfutjen e elementeve të rinj të muraturës, duke pasur kujdes që të formohet një perimeter i përshtatshëm përfutjen e muraturës së vjetër me atë të re, me dhëmbezime dhe fugatura që të mos të bien mbi njëra tjetrën.
- Futja e elementeve të rinj të muraturës (guri), pasi është pastruar dhe larë me ujë zgavra e krijuar, duke pasur kujdes në formimin e të ashtuquajturave dhëmbëzime. Të përdoren materiale lidhëse lehtësisht zgjeruese (ekspansive), të përbëra nga inerte të ngjashëm me atë që përbën materialin lidhës ekzistues

*Zgjidhet kjo metodë kur gjerësia e çarjes së muraturës i kalon 3 cm. Aplikohet kjo metodë përf të rindërtuar pjesërisht muraturën e afektuar nga çarja në mënyrë që materiali i ndërtimit të saj të vendoset në mënyrë korrekte (të mos bien fugat e një rreshti mbi fugat e reshit paraardhës).*

## 24. Restaurim mur guri/tulle me injektim llaç gëlqere

Ky çmim jepet lek/ml dhe përfshin

- Pastrimin e muraturës (çarjes) nga mbeturinat inerte
- Shplarjen e saj me ujë të bollshëm
- Pregatitjen e llaçit me përbërje si më poshtë
  - Rërë lumi e larë - 3 pjesë
  - Rërë vullkanike pluhur - 2 pjesë
  - Pluhur guri/tulle - 0.5 pjesë (nga guri/tullës i ndërtimit të muraturës)
  - Gëlqere e vjetër - 3 pjesë
- Injektimin e llaçit në brendësi të muraturës, çdo 50 cm, në të gjithë sipërfaqen e muraturës ku aplikohet ndërhyrja
- Si dhe të gjitha pajisjet dhe processet e tjera që nevojiten për përfundimin e punës në mënyrë perfekte

## V. PUNIME SUVATIM/RESTAURIM LYERJE

Të gjitha sipërfaqet që do të suvatohen duhet të **lagen** më parë me ujë. Aty ku është e nevojshme ujit do t'i shtohen materiale të tjere, në mënyrë që të garantohet realizimi i suvatimit në mënyrë perfekte.

Në çdo rast Kontraktori është përgjegjës i vetëm për realizimin përfundimtar të punimeve të suvatimit.

## 25. Restaurim suvaje

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup>dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, pregetitjen në kantier dhe realizimin e tij në vepër si dhe përfshin:

- Përcaktim i kufirit ndarës midis suvasë që do të ruhet dhe asaj që do të hiqet
- Konsolidimi I suvasë që do të ruhet dhe bordurimi I saj. Teknika që ndiqet për përcaktimin e kufirit të sipër përmendur bëhet manualisht nëpërmjet goditjeve jo të forta me spatul, mbi sipërfaqen e suvasë. Nëse suvaja I suporton këto goditje atëherë suvaja mund të ruhet, në rast se suvaja pëson thyrje apo plasaritje për shka të këtyre goditjeve, atëherë ky fragment duhet të zëvendësohet. Bordurimi I kufirit bëhet nëpërmjet konstolidimit të kufirit me llaç gëlqere ose cimento (në varësi të llaçit të suvasë ekzistuese).
- Pastrimi me furçë teli i sipërfaqes së muraturës e cila është e ekspozuar nga mungesa e suvasë
- Shplarja me ujë të bollshëm për largimin e të gjitha grimcave të shkëputura të llaçit, të mbetura në sipërfaqe.
- Aplikimi i dy shtresave të suvasë të realizuar me llaç me të njëjtat karakteristika si suvaja ekzistuese (llaç gëlqere ose llaç cimento). Suvaja e re duhet të jetë e lexueshme nga suvaja e vjetër (për profesionistët) në mënyrë që të mos japë informacion të gabuar në të

ardhmen (që të mos lexohet si material autentik). Ky diferencim bëhet duke e realizuar suvanë e re 2 milimetër më të hollë (në spesor) se suvaja autentike.

*Në rastet e objekteve jo monument kulture, mund të gjykohet e nevojshme që suvaja të realizohet ternerisht e re. Edhe në këtë rast, suvaja e re duhet të jetë e njëjtë me llaçin lidhës të muraturës; nëse llaçi lidhës është llaç gëlqere, e tillë duhet të jetë edhe suvaja. Nëse llaçi lidhës është llaç çimento, e tillë duhet të jetë edhe suvaja.*

*Kjo gjë do të gjykohet rast pas rasti nga specialistët restauratorë/konstruktori, gjatë zbatimit të subjektit.*

## 26. Suvatim muri i jashtëm me llaç gëlqere 1:3

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup>dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, prepatitjen në kantier dhe aplikimin e suvasë në vepër*

- Në çmim përfshihet, suvatimi i muraturës me llaç të përzjerë M25, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjeter për ta përfunduar plotësisht ssuvatimin.
- Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi gëlqere 1:3, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit, transporti i materialeve si dhe çdo detyrim tjeter për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

## 27. Restaurim dekor i fasada (plotësim i pjesëve të munguara) – Restaurim i medaljoneve në Kullën e Sahatit.

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup>dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, prepatitjen në kantier dhe realizimin e tij në vepër*

- Përcaktim të kufiri ndarës midis pjesëve të degraduara nga pjesët e ruajtura të dekorit
- Konsolidimi i materialit që do të ruhet - bordurimi I kufirit
- Pastrim me furçë teli i zonës ku do të vendoset fragmenti i ri i dekorit
- Shplarja me ujë të bollshëm
- Ndërtimi i kallëpeve me llamarinë të realizuar në bazë të modelit aktualë
- Inkastrimi në muraturë i shufrave metalike të filetuara për kapjen e fragmenteve të reja
- Plotësimi i pjesëve të munguara

*Është e rëndësishme që edhe në këtë rast të bëhet evidentimi i materialit autentik nga materiali i ri. Ky evidentim mund të bëhet nëpërmjet një fuge ndarëse 1mm ndërmjet dy fragmenteve.*

*Në rastet kur dekor ka dëmtime të vogla dhe nuk kanë nevojë për plotësimë fragmentesh, restaurimi i tyre do të bëhet me stukim me llaë të përgatitur me pluhur të materialit të dekorit dhe gëlqere.*

## 28. Ndërtim dekor çatie

*Ky çmim jepet lek/ml dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, prepatitjen në kantier dhe realizimin e tij në vepër*

- Ndërtimi i kallëpeve me llamarinë të realizuar në bazë të modelit aktual
- Inkastrimi në muraturë i shufrave metalike të filetuara për kapjen e fragmenteve të reja
- Plotësimi i pjesëve të munguara

## **29. Lyerje fasada me bojë me ngjyrë sipas Vizatimit teknik**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë, prebatitjen në kantier dhe realizimin e tij në vepër*

- **Për objektet jo monument kulture - Bojatisje e mureve të jashtme me bojë plastike për eksterier**
  - Stukimin dhe lëmimin e suvasë me stuko sintetik, aty ku është e nevojshme, për të patur të gatshme dhe në mënyrë perfekte sipërfaqet për lyerje.
  - Mbrojtja me letër e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (profilet e dritareve, si dhe e profilave të alukobondit dhe atyre plastike etj.).
  - Një dorë të vetme praimer të përshtatshëm, të aplikuar me furçë mbi mure.
  - Bojatisje me tre duar me bojë plastike, të bardhë dhe me ngjyrë sipas V.T., deri në mbarimin e punës në mënyrë perfekte.
  - Çdo punim dhe mjeshtëri të nevojshëm për mbarimin e plotë të punës në mënyrë perfekte.
- **Për objektet monument kulture - Bojatisje e mureve të jashtme me bojë hidromat me vetëajrosje për eksterier**
  - Stukimin dhe lëmimin e suvasë me stuko jo-sintetik, aty ku është e nevojshme, për të patur të gatshme dhe në mënyrë perfekte sipërfaqet për lyerje.
  - Mbrojtja me letër e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (profilet e dritareve, si dhe e profilave të alukobondit dhe atyre plastike etj.).
  - Një dorë të vetme praimer të përshtatshëm, të aplikuar me furçë mbi mure.
  - Bojatisje me tre duar me bojë plastike, të bardhë dhe me ngjyrë sipas V.T., deri në mbarimin e punës në mënyrë perfekte.
  - Çdo punim dhe mjeshtëri të nevojshëm për mbarimin e plotë të punës në mënyrë perfekte.

*Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit*

## **30. Suvatim Dekorativ vetëm tek objektet e reja (B.N.)**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin Suvatim Dekorativ realizuar me shablon, përzjerje çimento + pluhur mermeri + lidhës polimere*

- Rërë e larë lavatriçe
- Çimento e bardhë 42.5 R
- Llaç i përzier M25
- Pluhur mermeri
- Fibra Xhami
- Lidhës Polimere

- Kallëp rezine e modeluar artistikisht për dekor, me përdorim 50 herë
- Mirëmbajtje e kallëpit për ripërdorim 10 %

**31. Furnizim + Vendosje e medaljonit me portretin e Ahmet Zogut, i munguar në Kullën e Sahatit, sipas variantit origjinal të Skulptorit Odise Paskali.**

Ky çmim jepet lek/copë dhe përfshin

- Prdhimin e medaljonit sipas modelit origjinal, me materiale si modeli origjinal
- Vendosjen e tij në vepër.
- I gjithë procesi të monitorohet nga specialisti restaurator si dhe mbikëqyrësi i punimeve.

## **VI. DYER – DRITARE - VETRATA**

**32. F.V. Dyer druri pishe të stazhionuar kasë binari dopio xham, (ballkone dhe të hyrjes)**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin furnizimin me lëndë të parë si dhe montimin e tij në vepër

- Furnizim dhe vendosje në vepër dyerve të drurit (me një ose dy kanat), me dopio xham, konfiguracioni dhe përmasat e së cilave sipas V.T.
- një kontratelajo në dru pishe të stazhionuar (me trashësi 3 cm) e imprenjuar, me përmasa sipas gjerësisë së murit (që rritet si pasojë e veshjeve të ndryshme te murit), që do të fiksohet në mure me fasheta të përshtatshme hekuri (çdo 1 m) dhe me llaç çimento ose me shkumë.
- një telajo druri, që do të vidhoset në kontratelajo pas punimeve të suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit të derës në V.T., telajoja do të pajiset me mentesha dhe bllokuese të përshtatshme sipas tipit të derës, etj.
- Brava dhe çelës tip 'Yale' në tre kopje, doreza tunxhi, dhe piastra e gojëza përkatëse
- E gjithë vepra e muraturës si dhe çdo pajisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Kampion të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Pesha volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa

**33. F.V. Dritare / Vetrata druri pishe të stazhionuar kasë binar dopio xham**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Furnizim dhe vendosje në vepër dritareve/vetratave të drurit, me dopio xham, konfiguracioni dhe përmasat e së cilave sipas V.T. dhe realizohen nga prodhuesi në vendin e prodhimit, në dru pishe të stazhionuar, i imprenjuar e përbërë nga:
- një kontratelajo dërrase (me gjërsi 3 cm, me madhësi sa kasa e dritares) që do të vendoset në mur me fasheta hukuri përpara punimeve të suvatimit.
- një telajo dërrase (me seksione min 7x4cm) që do të vidhoset në kontratelajo pas kryerjes së suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatim telajo do të pajiset me mentesha dhe bllokues për tipe të ndryshëm dritaresh, kanate dritare, superliça etj.
- shirita druri të plotë rreth perimetrit të dritares nga brenda, kur realizohen me paturë dhe nga brenda e jashtë në mungesë të paturës (dhëmbit)
- duke përfshirë bërjen e shpatullave të muraturës, si dhe çdo pajisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë preçize

Kampion të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Pesha volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa

#### **34. F.V. Grila druri pishe të stazhionuar e tipit persiane me Kanata**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Furnizim dhe vendosje në vepër të grilave të drurit, me dy kanate, konfiguracioni dhe përmasat e së cilave sipas V.T. dhe realizohen nga prodhuesi në vendin e prodhimit, në dru pishe të stazhionuar, i imprenjuar,
- duke përfshirë çdo pajisje dhe proces tjetër për mbarimin e punës në mënyrë preçize

Kampion të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak.

Karakteristikat e drurit të pishës duhet të jenë si më poshtë:

- \* Lagështira jo më e lartë se 7%
- \* Pesha volumore rreth 450-540kg/m<sup>3</sup>
- \* Kufiri I rezistencës në tërheqje rreth 130MPa

#### **35. F.V. Dritare/Vetrata alumini, dopio xham dopio gomine**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Furnizim dhe vendosje dritare, përmasat e së cilës duhet të verifikohen nga ndërrmarja në kantjer
- Vendosja më parë e davancaleve të mermerit përmasat do të maten në vend
- Me kanata të hapëshme, duralumini tonaliteti do të përcaktohet në konsultim me arkitektin, me dopio xham e dopio gomine, sipas V.T.
- Duke përfshirë riparimin e patuarve, si dhe çdo paisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Kampionë të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak, si dhe në konsultim me arkitektin.

### **36. F.V. Qepena Metalike me hapje me elektromotorr**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Furnizim dhe vendosje të qepenave, përmasat dhe konfiguracioni i së cilëve jepet në fletët grafike të projektit.
- Me elektromotorr për hapjen dhe mbyllje elektrike
- Duke përfshirë riparimin e patuarve, si dhe çdo proces e paisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Kampionë të artikujve të propozuar do t'i paraqiten Supervizorit të Kantjerit për aprovim paraprak, si dhe në konsultim me arkitektin.

### **37. F.V. Tenda djelli me copë të gomuar me mekanizëm hapje mbyllje, modeli e ngjyra sipas Vizatimit teknik**

### **38. Restaurim dyer/dritare/grila persiane të realizuara me dru masiv**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Çmontimin e kujdeshëm të dyerve/dritareve/grilave në prezencë të restauratorit
- Transportin e tyre për në punishtet ku do të realizohet restaurimi i tyre, i cili përfshin këto procese
  - Kruajtjen e shtresave të bojës që mund të kenë dyrt/dritaret/grilat
  - Investigimin e hollësishëm për të evidentuar nëse ka fragmente të dyerve/dritareve/grilave që duhet eleminuar për shkak të shkallës së degradimit.
  - Eleminimin e pjesëve tejet të degraduara
  - Konsolidimin e fragmenteve që do të ruhen (trajtimin e tyre me antimolë, insekticid e vaj lini)
  - Plotësimi i fragmenteve që mungojnë duke ndekur elementët e dekorimit të derës/dritares/grilës (në rast se do të ketë)
  - Lyerjen e tyre me bojë arre
  - Transportin për në kantier
  - Montimin në vepër, në përfundim të punimeve të restaurimit

Duke përfshirë riparimin e patuarve, si dhe çdo proces e paisje tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

**39. Furnizim Vodosje e pragjeve nëpër dyer + dritare + vetrata, me pllakë granili të armuar,  
me bojë dhe e lustruar, t = 3 cm**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Furnizimin me hekur për armim dhe vendosjen e tij në vepër
- Furnizim dhe vendosje në vepër e pllakës së granilit e lyer me bojë dhe e lustruar (t = 3 cm) me gjërsi dhe gjatësi të matur në vend

## **PUNIME TË NDRYSHME**

**40. Arkitrarë beton arme C-20/25**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:*

- Prodhimin e arkitrarëve të armuar në menyre të rregullt, sipas udhëzimeve në vizatime, me beton C-25/30 (marka 300) të vibruar mirë, me dozaturë per m<sup>3</sup> sipas përshkrimit në paragrafin **IV** duke përfshirë kallëpet, përforcimin, skelen, përforcimin me hekur si dhe çdo gjë tjeter të nevojshme përfundimin e punës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte.

**41. Pragje dritare/dyer/vetrata me pllakë granili të armuar me bojë**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Furnizimin e materialit
- Nivelimin dhe pregetitjen korrekte të muraturës para se të vendoset pragu
- Vendosjen e tyre në vepër (pragjet e dritareve/dyerve/vetratave mund të janë të brendëshme ose të jashtme)
- Çdo detyrim, pajisje apo proces përfunduar punën në mënyrë perfekte

Pragjet do të janë me material granil të derdhur të pregetit paraprakisht, duhet të kenë kënde të mprehta dhe me pikore për kullimin e ujit.

**42. Parapete me balastra betoni të parapërgatitura në ballkone**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Furnizimin e materialit (balastrave si dhe brezit të sipërm) sipas V.T.
- Nivelimin dhe pregetitjen korrekte të muraturës para se të vendoset parapeti
- Vendosjen e tyre në vepër (pragjet e dritareve/dyerve/vetratave mund të janë të brendëshme ose të jashtme)
- Çdo detyrim, pajisje apo proces përfunduar punën në mënyrë perfekte

Pragjet do të janë me material beton i derdhur, i përgatitur paraprakisht. Brezi i sipërm duhet të ketë kënde të mprehta dhe me pikore për kullimin e ujit.

**43. Veshje shkallësh dhe sheshpushime të jashtme me pllaka granili**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Pastrimin e kujdeshëm të sipërfaqes që do të vendosen pllakat e granilit
- Rrafshimin dhe nivelimin e vendit
- Ngjiten e pllakave në vend (me llaç çimento ose kollë)
- Çdo detyrim, pajisje apo proces përfunduar punën në mënyrë perfekte.

Dimensionet, pozicioni dhe mënyra e shtrimit të tyre jepet në fletët grafike.

#### **44. F.V. Parapete të reja ballkoni me hekur dekorativ, sipas Vizatimit teknik**

Ky çmim jepet lek/kg dhe përfshin:

- Pastrimin e kujdeshëm të sipërfaqes që do të vendoset parapet metalik
- Rrafshimin dhe nivelimin e vendit
- Furnizimin e parapetit I cili paraprakisht është I pregetitur dhe trajtuar me antindryshk dhe bojë të posaçme
- Vendosjen e tij në vepër
- Çdo detyrim, pajisje apo proces përfunduar punën në mënyrë perfekte

#### **45. F.V. Konstruksion metalik për dysheme ballkoni**

Ky çmim jepet lek/kg dhe përfshin:

- Furnizimin profileve të çelikut (sipas V.T.): materiali të jetë çelik, profil dopio "T", I markës S275, I cili paraprakisht është I trajtuar me antindryshk
- Vendosjen e tij në vepër sipas skemës së përcaktuar në fletët grafike të projektit
- Çdo detyrim, pajisje apo proces përfunduar punën në mënyrë perfekte

#### **46. Pastrim dhe lyerje kangjella metalike të parapeteve në ballkone ose kangjellat e dritareve**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Pastrimin me furçë teli dhe zmerilim I sipërfaqes së kangjellave metalike për eleminimin e ndryshkut që mund të kenë zënë me kalimin e kohës
- Investigimin e gjendjes së tyre pas pastrimit; nëse ka zona ku materiali mund të jetë shumë i ndryshkur dhe të mos jetë më në gjendje të kryejë funksionin e ti
- Trajtimin e tyre me antindryshk
- Lyerjen me bojë për sipërfaqe metalike (ngjyra e bojës përcaktohet në V.T.)

#### **47. Pastrim dhe lyerje parapete ekzistuese betoni**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Do të bëhet pastrimi me furçë teli i materialit të degraduar të betonit dhe suvasë.
- Do të bëhet pastrimi me furçë teli i hekurave të zbuluar dhe të korroduar dhe zmerilimi i sipërfaqes së hekurit për eleminimin e ndryshkut.
- Përpara se të aplikohet betoni i ri duhet që të bëhet pastrim me ujë të bollshëm i zonave ku është bërë pastrim me furçë teli, çukitje e sipërfaqes për të mundësuar lidhjen e betonit të ri me betonin egzistues.

- Investigim i madhësisë së zgavrave në spërfaqen e betonit, për të përcaktuar procesin pasardhës: stukim apo do të kenë nevojë për mbushje me beton të ri)
- Në rast se do të nevojitet, betoni i ri duhet të jetë i njëjtë me betonin ekzistues (granulometria e çakëllit ose zhavorrit me të cilin do të pregetitet betoni do të përcaktohet në vend nga restauratori dhe supervizori)
- Suvatimi i parapetit (nëse është e parashikuar në projekt)
- Lyerja e sipërfaqes me bojë sipas V.T.

#### **48. Brez b/a, C-15/20 (muraturë e armuar)**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Realizimi i brezit, në të gjithë gjërësinë e muraturës poshtë dhe lartësi prej 15 deri në 20 cm, i armuar sipas KTZ dhe STASH, i realizuar me betonin të prodhuar në vepër, i shtuar në shtresa të holla të vibrues mirë,
- beton M 150 deri te M 250 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

#### **49. Ndërtim shkallë druri**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:*

- Furnizimin e lëndës së drurit; stazhionuar në mënyrë natyrale për një periudhë më të gjatë se 5 vjet dhe i trajtuar paraprakisht me antimolë, insekticid dhe vaj lini
- Ndërtimin e konstruksionit të shkallëve të drurit (sipas V.T.)
- Rifiniturat
- Si dhe çdo gjë tjetër që nevojitet për përfundimin e punës në mënyrë perfekte.

#### **50. Gërmim dheu për themele muri rrethues dhe kanale drenazhimi**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:*

Gërmim dheu për themele, për kanale drenazhimi ose punime të tjera nëntokësore, deri në thellësinë 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të tharë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjeve, trungjeve, gurëve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m<sup>3</sup>, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujrate të zeza, tubacionet në përgjithesi etj, përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit të themelive me materialin e gërmimit të kryer me krah, si dhe transportin e të gjithë mbetjeve në një vend të autorizuar publik.

I kryer me krah përfshirë vendosjen brenda ambjentit të kantjerit të materialit që rezulton.

#### **51. Shtresë dhe mbushje me zhavorr**

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:*

Furnizmin e materialit dhe shtrimin e tij mbi terrenin e ngjeshur mirë më përpara, me zhavorr lumi pa përbërje argjilore dhe me lartësi sipas udhëzimeve të supervizorit gjatë zbatimit të punimeve si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë fund punës.

## 52. Drenazhim, vendosje tubo PVC Ø200mm me vrima për drenazhim

*Çmimet jepen për çdo element në mënyrë të veçantë duhet të përfshijnë*

- Vendosje e tub PVC Ø 200 mm, me vrima e mbështjellë me batanije artificiale gjeotekstil, i cili vendoset pasi është hapur kanali i cili do të mbushet me zhavorr, si dhe para vendosjes së shtresave të trotuarit;
- çdo gjë tjetër të nevojshme përfundimin e punës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte.

## 53. Shtresë betoni C-12/15

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:*

- Pregatitjen dhe hedhjen e tij në vepër mbi shtresat e preqititura më parë dhe i formuar nga shtresa të holla të vibruara mirë, duke përfshire çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë të rregullt.
- Çdo gjë tjetër të nevojshme përfundimin e punës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte.

Trashësia e shtresës sin ë V.T.

## 54. Themel beton arme C- 16/20

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:*

- Themelet të kryera prej betoni Markë C-16/20 të dozuar për m<sup>3</sup> dhe të pastruar në shtresa të trasha të vibruar mirë, me dimensione dhe formë të treguar në vizatimet përkatëse, duke përfshirë kallëpet, formën e punës, mbështetjen dhe të gjitha kërkesat për të kompletuar punën me cilësi.

## 55. Mur rrethues guri me llaç cimento M 25

*Ky çmim jepet lek/m<sup>3</sup> dhe përfshin:*

- Muraturë e ngritur deri në lartësinë e dhënë në V.T.,
- Ndërtuar me gurë gëlqeror me përmasa më të mëdha se 20 cm me formë të përshtatshme dhe
- Lidhur me llaç bastard m-25, sipas pikës
- Duke përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, skela e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Në çdo një metër lartësi muri me gur, duhet të realizohet një brez betoni me beton M 100 me lartësi 10 - 15 cm.

## 56. Pllake b/a granili mbi mure rrethues

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Furnizimin me lëndën e parë (pllaka, material lidhës, silikon, etj.)
- Pastrimi nga pluhurat e sipërfaqes që do të vishen me pllaka
- Vendosjen e tyre në muraturë me llaç trashësi jo më të vogël se 2 cm
- Llaçi duhet të jetë rezistent ndaj ngricës dhe koeficienti i marrjes së ujit në % të jetë < 3 %.
- Mbushjen e fugave me një material të posaçëm. (Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike, si p.sh. silikon).
- Për çdo sipërfaqe 30 m<sup>2</sup> të veshur me pllaka, është e nevojshme vendosja e fugave lëvizëse.

Të gjitha pllakat duhet të janë rezistente kundër ngricës si dhe të kenë një durueshmëri të lartë.

### **57. Shtrim sheshi në oborre me pllaka granili me bojë**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Furnizimin me lëndën e parë (pllaka, llaç, etj.)
- Nivelimin dhe ngjeshjen e shtresës së terrenit (në rastet kur nuk ka shtresë betoni ekzistuese)
- pllaka të vendosura në vepër mbi një shtrese betoni të realizuar më parë
- ngjitja pllakave realizohet me shtresë llaçi
- prerjen me prerës pllakash dhe ngulitjen e inkastimeve në mur, vendosjen në vepër në mënyrë plotësisht të ngjeshur ndërmjet tyre dhe të stkuara me bojakë çimentoje në fugatura
- larje dhe pastrim
- çdo detyrim tjetër për mbarimin e plotë të dyshemesë në mënyrë perfekte.

### **58. Veshje shkallësh dhe sheshpushime të jashtme me pllaka granili**

Ky çmim jepet lek/m<sup>2</sup> dhe përfshin:

- Furnizimin me lëndën e parë (pllaka, material lidhës, silikon, etj.)
- Pastrimi nga pluhurat e sipërfaqes që do të vishen me pllaka
- Vendosjen e tyre në muraturë me llaç trashësi jo më të vogël se 2 cm
- Llaçi duhet të jetë rezistent ndaj ngricës dhe koeficienti i marrjes së ujit në % të jetë < 3 %.
- Mbushjen e fugave me një material të posaçëm. (Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike, si p.sh. silikon).
- Për çdo sipërfaqe 30 m<sup>2</sup> të veshur me pllaka, është e nevojshme vendosja e fugave lëvizëse.

Të gjitha pllakat duhet të janë rezistente kundër ngricës si dhe të kenë një durueshmëri të lartë.

### **59. F.V. Kangjella rrëthimi me punime hekuri, sipas Vizatimit teknik**

Ky çmim jepet lek/kg dhe përfshin:

- Furnizimin dhe vendosjen në vepër të kengjellave (konfiguracioni sipas V.T.), të cilat duhet të jenë të trajtuar paraprakisht me antindryshk.
- Lyerje me disa duar bojë vaji sintetik (0.2 kg/m<sup>2</sup>) mbi sipërfaqet e tyre, deri në mbarimin e punes në mënyrë perfekte
- Skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo detyrim dhe punim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte
- Çdo punim dhe mjeshtëri të nevojshëm për mbarimin e plotë të punës në mënyrë perfekte.
- Kampionët duhet t'i paraqiten me përpara Supervizorit të Kantjerit

## **60. F.V. Portë dekorative hekuri, sipas Vizatimit teknik**

*Ky çmim jepet lek/kg dhe përfshin:*

- Furnizimin dhe vendosjen në vepër të portave metalike (konfiguracioni sipas V.T.), të cilat duhet të jenë të trajtuar paraprakisht me antindryshk.
- Lyerje me disa duar bojë vaji sintetik (0.2 kg/m<sup>2</sup>) mbi sipërfaqet e tyre, deri në mbarimin e punes në mënyrë perfekte
- Skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo detyrim dhe punim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte
- Çdo punim dhe mjeshtëri të nevojshëm për mbarimin e plotë të punës në mënyrë perfekte.
- Kampionët duhet t'i paraqiten me përpara Supervizorit të Kantjerit

## **2. PROJEKTI I INFRASTRUKTURES – SPECIFIKIME TEKNIKE**

### **1- PUNIME PASTRIMI DHE PRISHJE**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME:**

##### **Referencat**

Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi. Botimet janë të referuara vetëm me emertimin e tyre.

##### **Ligjet dhe normat shqiptare**

Duhet të sigurohet përputhshmëria strikte me të gjitha rregulloret aktuale shqiptare për spastrimin dhe heqjen e materialeve të ndërtimit.

##### **Standartet dhe normat evropiane:**

DIN 18007 Punët e Prishjes - Terminologjia, teknikat dhe aplikimet

DIN EN 74 Bashkuesit, morsetat dhe pllakat metalike për përdorim në skelat e punës dhe konstruksionet e përkohshme me tuba çeliku; Kërkesat dhe procedurat e testimit.

DIN IEC 60364-7-704\_ Ndërtimi i instalimeve të tensionit të ulët - Pjesa 7-704: Kërkesa për instalimet ose vendet e veçanta - instalimet e ndërtimit dhe prishjes (IEC 64/1339 / CD: 2003).

#### **DORËZIMET**

##### **Deklaratat**

Procedurat e propozuara për prishjen dhe largimin e materialeve të ndërtimit nga kantieri duhet ti dorëzohen për miratim Inxhinierit zbatues përpëra se të fillojnë punimet e prishjes. Procedurat duhet të sigurojnë heqjen e kujdeshme dhe sistemimin e materialeve, koordinimin me veprat e tjera në progres, një grafik të shkëputjes së ndërtësës nga furnizimet publike, të gjitha lejet e nevojshme nga kompanitë e furnizimit të furnizimeve publike, dhe një përshkrim i detajuar i metodave dhe pajisjeve që do të përdoren për secilin operacion si edhe radha e këtyre operacioneve.

##### **Survejimi i gjendjes aktuale**

Në rastet kur pronat përreth mund të dëmtohen nga punimet atëherë Kontraktori duhet të kryejë me shpenzimet e tij një survejim të detajuar të gjendjes së pronave përreth duke përfshirë edhe materiale fotografike, një kopje e këtij dokumenti duhet t'i paraqitet Inxhinierit për miratim para fillimit të punimeve.

##### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME**

Puna përfshin prishjen dhe heqjen e të gjithë objekteve të specifikuara. Punimet e prishjes nuk do të fillojnë pa marrjen e miratimit nga Inxhinieri. Të gjitha materialet që dalin nga procesi i prishjes

dhe rrënimit, do të bëhen pronë e Kontraktorit, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, dhe do të hiqen nga sheshi i ndërtimit. Plehrat dhe mbeturinat do të transportohen jashtë kantierit çdo ditë, me përjashtim të rasteve kur udhëzohet ndryshe nga Inxhinieri; akumulimi i materialeve të tilla ndalohet si brenda dhe jashtë ndërtesave. Materialet të cilat nuk mund të hiqen përditë do të depozitohen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara nga Inxhinieri. Kontraktori duhet të sigurojë kontenierë të përshtatshëm për depozitimin e mbeturinave të ndryshme ndërtimore dhe do t'i zbrazë këto kontenierë këto sipas shpeshtësisë së nevojshme. Të gjithë kontenierët do të mbulohen në çdo kohë në mënyrë për të parandaluar ngritjen e pluhurit dhe mbeturinave nga era. Nëse Kontraktori identifikon drurë të kalbur ose asbestos gjatë punimeve të prishjes ai duhet të njoftojë menjëherë Inxhinierin dhe të marrë masat e duhura për ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë, si edhe t'i propozojë Inxhinierit masat e përshtatshme për largimin të këtyre elementeve. Kontraktori duhet të paraqesë dëshmi për asgjësimin e duhur të materialeve nëse i kërkohet nga Inxhinieri.

## **EKZEKTIMI**

### **OBJEKTET EKZISTUESE**

#### **Nënstacionet**

Nënstacionet ekzistuese do të prishen, me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe. Çdo mur do të prishet deri në bazën e dyshemesë së betonit përveç rasteve kur specifikohet ndryshe. Shtyllat ekzistuese të betonit do të prishen përveç rasteve nëse specifikohet ndryshe.

#### **Furnizimet publike dhe pajisjet përkatëse**

Furnizimet publike ekzistuese duhet ndërpriten, të çmontohen me kujdes, dhe të taposen në përputhje me normat dhe rregulloret shqiptare dhe mbas aprovimit të Inxhinierit. Nëse hasen linja të furnizimeve që nuk shfaqen në vizatime, duhet të kontaktohet Inxhinieri për udhëzime të mëtejshme.

#### **Furnizimet e brendshme**

Para fillimit të punimeve të prishjes, duhet të shkëputen furnizimet publike në zonën e prishjes dhe do të sigurohet që nuk ndodh rilidhja e tyre e paqëllimshme.

Gjatë prishjes së suvatimeve të mureve, suvaja do të pastrohet në kufijtë e seksionit të rrënuar.

#### **Sipërfaqet dhe dyshemetë e betonit**

Dyshemetë e betonit, apo siperfaqet e asfaltit apo bitumit duhet të priten me sharrë në një thelli së deri në 5 centimetra nën nivelin e pllakës ekzistuese. Prerjet duhet të jenë të drejta dhe të pastra deri në limitet e sipërfaqes apo pllakës së betonit. Matrapikët do të përdoren deri në vendin e prerjes dhe nuk do të përdoren në vend të sharrës.

Për prishjen e dyshemeve dhe rifiniturave referojuni 1.4.6.

Kujdes i veçantë duhet të bëhet kur spastrohet rifinitura e dyshemesë mbi elementët e lehtë prej betoni.

#### **Betonet**

Betonet duhet të priten me sharrë në një thellësi jo më pak se 5 centimetra.

### **Kunjat prej druri**

Gjatë punimeve të prishjes të gjithë kunjat prej druri duhet të hiqen nga muret dhe tavanet.

### **Muret**

Gjatë prishjes së e mureve ose modifikimeve të tyre kujdes duhet të tregohet për të siguruar prerje të rregullta në limitet e seksioneve të prishura. Kujdes duhet të tregohet për të mos lejuar rënien e ngarkesave të rënda dinamike mbi dyshemetë e kateve gjatë punimeve të prishjes.

### **Gërmimet**

Për të gjitha gërmimet, kanalet dhe gropat referoju specifikimeve Teknike 2.2.3.

### **Stukimi**

Kurdoherë që sipërfaqet permanente ekzistuese dëmtohen nga Kontraktori gjatë kryerjes së punimeve, ai duhet t'i riparojë, suvatojë, dhe t'i stukojë këto sipërfqaqe deri në kufirin e sipërfaqeve të pa dëmtuara.

## **HEQJA E MATERIALEVE DHE PRONËSIA E MATERIALEVE TË ÇMONTUARA**

### **HEQJA E MATERIALEVE DHE PAJISJEVE EKZISTUESE**

Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në sektionet e tjera, të gjitha materialet dhe pajisjet që dalin gjatë punimeve të prishjeve, të cilat nuk ripërdoren, janë pronë e kontraktorit dhe duhet të largohen nga kantieri. Pronësia për të gjitha materialet dhe pajisjet që dalin nga prishja, i jepet kontraktorit pas miratimit të procedurave të prishjes nga Inxhinieri dhe autorizimit të tij për fillimin e punimeve të prishjes.

Klienti nuk do të jetë më përgjegjës për kushtet, humbjen apo dëmtimin e këtyre materialeve dhe pajisjeve mbas Njoftimit për Fillimin e Punës.

### **Kostot e transportit**

Kontraktori duhet të përballojë të gjitha kostot që lidhen me transportin e mbetjeve dhe materialeve që do të hiqen nga zona e ndërtimit.

### **Kontrolli i zhurmave dhe vibrimeve**

Në rastet kur punimet e prishjes janë të lokalizuara pranë ndërtesave që janë në afërsi të kantierit të ndërtimit ose që janë në përdorim nuk do të lejohen zhurmat dhe vibrimet intensive gjatë orarit normal të punës në mënyrë që mbahen shqetësimet nga operacionet e ndërtimit në minimum. Koordinimi i punëve të tillë do të bëhet me Inxhinierin.

### **Kontrolli i pluhrave**

Masat e duhura duhen marrë për të kontrolluar shpërhapjen e pluhurit dhe për të shmangur ndotjen nga pluhuri të zonës përreth. Këto masa duhet të jenë në përputhje me të gjitha rregulloret për kontrollin e pluhurave që imponohen nga agjencitë lokale të ndotjes së ajrit. Gjatë proceseve të prishjes në ndërtesat që janë ende në përdorim duhet të përdoren mbulesa për të

mbrojtur zonat që janë ende në funksionim. Kur elementet që janë pjesë e prishjes përbajnjë fibra duhet të merren masa që të parandalohet inhalacioni i tyre nga popullata. Spërkatja me ujë i materialeve të tilla dhe përdorimi i maskave të pluhurit duhet të jetë një masë minimale e mbrojtjes. Shpimet në materialet fibroze janë të ndaluara.

## **MBROJTJA**

### **Objektet dhe pajisjet ekzistuese**

Para fillimit të punimeve Kontraktori së bashku me Inxhinierin duhet të inspektojë dhe të identifikojë të gjitha objektet dhe pajisjet ekzistuese të cilat do të mbahen ose do të ripërdoren. Objektet dhe pajisjet ekzistuese do të: (a) lihen në vendin e tyre, apo (b), do të ripërdoren, apo (c) do të mbeten pronë e Klientit, dhe do të mbrohen duke përdorur mbulesa, mbështetje, apo mbështetje të përkohshme. Objektet të cilat dëmtohen gjatë kryerjes së punës, do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose do të zëvendësohen me artikuj të rinj nga Kontraktori. Elementet strukturore nuk duhet të mbingarkohen. Mbështetje shtesë dhe përforcime duhet të sigurohen për të rritur stabilitetin e ndërtesave që mund të jenë dobësuar nga aktivitetet e prishjeve. Nesë vihen re humbje të stabilitetit strukturor (defleksione të tepërtë, plasaritje, etj) Kontraktori duhet të marrë masa të menjëhershme për të siguruar evakuimin e menjëhershëm, mbylljen e zonës së ndërtimit dhe të informojë Inxhinierin.

### **Ulja e materialeve**

Kur materialet apo mbetjet e ndërtimit ulen nga lartësitë, duhet treguar kujdes për të parandaluar lëkundjen, renien, dhe pozicionimin e tyre në një mënyrë që krijon rrezik për sigurinë e personelit, dhe të pasurisë publike.

### **Tubat e evakuimit të mbetjeve**

Nëse Kontraktori do të përdorë tub evakuimi të mbeturinave për të transportuar mbeturinat nga katet e sipërme të ndërtesës në kazanin e mbetjeve, atëherë këto tuba duhet të jetë të mbështetura në mënyrë adekuate, dhe të instalohen nga një montues me përvojë, dhe të jenë të lidhura ngushtë në të gjitha nyjet. Kontenieri i mbetjeve do të jetë i mbuluar me çarçaf i cili duhet të jetë i lidhur mirë në të gjitha anët për të parandaluar daljen e pluhurit të tepërt nga kontenieri. Akses i përshtatshëm dhe i sigurt, do të mundësohet në majë të tubit të evakuimit për të kriuar kushte të mira sigurie gjatë hedhjes së mbeturinave në tub.

### **Furnizimet ekzistuese**

Kabllot ekzistuese elektrike dhe tubat elektrikë që do të ripërdoren, duhet të shkëputen me kujdes nga kapset e tyre dhe do të ri-posicionohen larg vendeve ku kryhen operacionet e ndërtimit për ti mbrojtur nga dëmtimi. Para fillimit të punimeve të prishjes Kontraktori duhet të kontrollojë përvendndodhjen e rrjeteve të fshehta të furnizimeve.

### **Dëmtimet nga temperaturat e ulta**

E tërë ndërtesa apo struktura duhet të ruhet nga dëmtimet e temperaturave të ulta si ngrirja e tubave të ujit gjatë punimeve të prishjeve.

## Zëvendësimi i dritareve dhe dyerve

Gjatë zëvendësimit të dritareve dhe dyerve Kontraktori duhet të sigurojë që të gjitha ato të zëvendësohen në të njëjtën ditë në mënyrë që ndërtesa të jetë e sigurt gjatë natës.

### Punimet e çative

Gjatë punimeve të çative Kontraktori duhet të sigurojë që ndërtesa apo struktura të mbetet e mbuluar gjatë gjithë kohës. Materialet për mbulimin e përkohshëm të tilla si plastmaset duhet të janë të gatshme në rast nevojite. Përgjithësisht çmontimi i çative duhet të bëhet me fazë me qëllim që të mbahet në minimum kërkesa për mbulim të përkohshëm.

### Periudhat e mbylljes së kantierit

Gjatë periudhave të mbylljes së kantierit, Kontraktori duhet të sigurojë se të gjitha objeket janë të siguruara dhe duhet të vizitojë kantierin çdo ditë për të kontrolluar situatën.

## SHËNDETI DHE SIGURIA

### Mbikqyrja kompetente

Të gjitha punimet e prishjes duhet të kryhen nën mbikqyrjen konstante të brigadierëve të kualifikuar dhe me eksperiencë.

### Mbrojtja për këmbësorë

Atje ku siguria e këmbësorëve dhe shoferëve rrezikohet duhen përdorur barrikada trafiku me drita (gjatë orëve të errësirës) dhe shenjave të përshtatshme për drejtimin e trafikut larg zonës së ndërtimit. Duhet të sigurohen gjithashtu edhe pasarela të përkohshme dhe mbulesa për mbrojtjen e kalimtarëve.

### Punimet me lëndët e nxehta dhe shpërthyese

Ndalohet magazinimi i bombolave të gazit në bodrume, në hapësirat e shkallëve, në korridoret dhe në rrugët e evakuimit. Gjatë punës me lëndë djegëse duhet të mbahen në afërsi të vendit të punës bombolat e fikjes se zjarrit sipas DIN EN 3.

### Veshjet mbrojtëse

Gjatë punimeve të prishjeve të gjithë punëtorët duhet të kenë veshjet e duhura mbrojtëse për proceset përkatëse të punës, duke përfshirë syzat mbrojtëse, maskat e pluhurit, këpucët e sigurisë, dorezat dhe kapelet mbrojtëse plastike

### Prerja e metaleve

Gjatë prerjes së metaleve me troko apo me oksigjen, veçanërisht në tunelet e shërbimit kontraktori duhet të sigurohet se shkëndijat dhe metali i shkrirë nuk bien mbi zona të pakontrolluara.

### Qarqet elektrike

Para fillimit të çdo punimi për prishjen e ndërtesave duhet siguruar që ndërtesa apo kantieri brenda hapësirës publike është i shkëputur plotësisht nga qarku elektrik dhe se të gjitha qarqet e brendshme elektrike janë pa energji elektrike.

### **Furnizimet publike të jashtme**

Të gjitha furnizimet elektrike dhe furnizimet e tjera publike duhet të mbrohen. Furnizimet publike të gjitha furnizimet publike nëntokësore në kantier para fillimit të punimeve të gërmimit. Lejet përgjithësore do të merren nga furnizuesit publikë dhe një kopje e lejeve do t'i dorëzohet Inxhinierit. Aty ku specifikohet shkëputja e furnizimeve ekzistuese duhet të përdoren barrikada të miratuara, mbulesa të përkohshme për zonat e ekspozuara, dhe lidhje të përkohshme me sistemet elektrike dhe të furnizimeve të tjera. Kur pajisjet mekanike të tillë si vinçat, pajisjet hidraulike, eskavatorët dhe gurthyesët përdoren gjatë procesit të prishjes apo rrënimit, masa të veçanta duhet të merren përgjithësore që asnjë pjesë e makinave të tillë të mos bjerë në kontakt me kabllot ajrore apo nëntokësore të energjisë elektrike ose me telat dhe kabllot e telefonit. Distancat e nevojshme nga linjat ajrore të tensionit të lartë do të dakordësohen dhe miratohen nga kompania e shpërndarjes së rrymës elektrike. Një kopje e kësaj leje i paraqitet Inxhinierit. Kontraktori duhet të informojë autoritetet përkatëse mjaftueshmërisht në avancë përparrë fillimit të punimeve, në mënyrë që të ndërmerren hapat e nevojshëm për zhvendosjen e kabllave.

Zakonisht, linjat ajrore që kalojnë përmbi rrugë automobilistike duhet të shënohen në mënyrë të quartë duke përdorur një shirit të kuq dhe të bardhë dhe tabela të vendosura 5 m çdo anë të linjës me paralajmërimin përkatës "Lartësia maksimale e lejueshme x, xx m".

### **Lëndët shpërthyese**

Përdorimi i Lëndëve Shpërthyese nuk lejohet.

### **Djegia**

Djegia nuk lejohet.

### **PASTRIMI**

#### **MBETJET DHE PLEHRAT**

Kontraktori nuk mund të shfrytëzojë kazanët e mbeturinave të komunitetit për hedhjen e mbeturinave të ndërtimit apo materialeve të dala nga rrënim, por duhet të përdorë kontenierë të posaçëm për asgjësimin e çdo materiali të ndërtimit dhe duhet t'i transportojë mbetjet jashtë kantierit aq shpesh sa është e nevojshme. Largimi i mbeturinave dhe plehrave duhet të bëhet në mënyrë të tillë që do të mos lejohet derdhja e tyre nëpër rrugët apo zonat përreth kantierit. Çdo derdhje aksidentale e mbeturinave apo plehrave në rrugë apo në zonat përreth duhet pastruar.

### **Pastrimi**

Ndërtesa apo struktura dhe terreni urban duhet pastruar nga pluhuri dhe mbetjet e ndërtimit mbas përfundimit të punimeve të prishjes.

## PUNIME PASTRIM KANTIERI

### EKZEKUTIMI

Referoju kërkesave të përgjithshme dhe specifikimeve në Kapitullin 1.1 dhe 1.2.

#### **Prerja e pemëve dhe trungjeve më të lartë se 2.5m**

Në përgjithësi, pemët të cilat nuk pengojnë rehabilitimin apo ndërtimin e një ndërtese të re, infrastrukturës ose hapësirës publike duhet të mbrohen nga dëmtimi gjatë punimeve të pastrimit (duke përfshirë edhe rrënjet). Në rast se heqja e tyre është e domosdoshme duhet të merren masat specifike paraprake e duhura për të shmangur ndonjë dëmtim të personave ose objekteve përreth. Pemët më të larta se 10 m duhet të priten në pjesë me gjatësi maksimale 3 m. Pjesa e prerë duhet të lidhet me një litar apo kabllo dhe duhet të larguar larg nga zona e përcaktuar e sigurisë për personelin ose larg objekteve. Kontraktori

Do të presë pemët vetëm pas marrjes së miratimit nga Inxhinieri mbikqyrës dhe udhëzimeve të hollësishme, nëse pemët duhet të priten apo nëse ato mund të gërmohen me kujdes të mbillen në një vend tjetër.

#### **Prishja e strukturave, gardheve, etj.**

Kontraktori duhet të prishë me kujdes dhe të rrafshojë strukturat sipas udhëzimeve të Inxhinierit. Komponentët do të çmontohen, pastrohen dhe do të grumbullohen në pirgje të veçanta.

Materialet, të cilat sipas mendimit të Inxhinierit nuk janë të përshtatshme për ripërdorim, duhet të largohen nga kantieri dhe të dërgohen në një landfill (siç specifikohet në dokumentat e tenderit ose siç udhëzohet nga inxhinieri mbikqyrës).

## PUNIMET E PRISHJES

### EKZEKUTIMI

Referoju kërkesave të përgjithshme dhe specifikimeve në Kapitullin përkatës.

#### **Prishja e çative dhe tarracave**

Ky process përbledh:

Spastrimin e çative nga tjegullat, dërrasat, mushamatë, dhe kompensatat, si edhe prishjen e skeletit struktural që mund të përbëhet nga kapriatat, trarët, qoshet metalike, ulluqet horizontal, ulluqet vertikalë, fiksuesit e ndryshëm, dhe oxhakët. Prishjen e tavanëve përfshin ristelat mbështetëse, nyjet, suvatë dhe tubat elektrike.

Heqjen e membranave hidroizoluese nga tarracat, duke përfshirë shtresat metalike dhe bituminoze përbri oxhaqeve dhe parapetave.

Prishjen e suvave në sipërfaqet e sheshta me gjërsë prej të paktën 30 cm për instalimin e membranave të reja hidroizoluese.

#### **Prishja e muraturës prej guri**

Përfshin prishjen e plotë ose të pjesshme të muraturave prej guri, duke përfshirë themelet.

Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha masat e nevojshme për përforcimin dhe konsolidimin e ndërtesave përreth (nëse është e nevojshme).

### **Prishja e muraturës prej tulle**

Përfshin prishjen e plotë ose të pjesshme të muraturave prej tulle ose elementeve prej qeramike duke përfshirë pllakat dhe themelet. Kontraktori duhet të sigurojë të gjitha masat e nevojshme për përforcimin dhe konsolidimin e ndërtesave përreth (nëse është enevojshme).

### **Prishja e strukturave betonarme:**

Përfshin prishjen e plotë ose të pjesshme dhe spastrimin e strukturave betonarme dhe elementeve të tyre strukturalë si edhe themeleve. Çeliku duhet të pritet rrafsh me sipërfaqen që të mundësojë mbulimin e armimit nga rifinitura përkatëse.

Para fillimit të punimeve të prishjes kontraktori duhet të sigurojë stabilitetin strukturor të pjesës së mbetur të objektit. Nëse është e nevojshme përforcimet e duhura të bëhen nga Kontraktuesi.

Kur kryhet prerja apo prishja e plotë apo e pjesshme e dyshemeve të lehta prej betoni pjesa e mbetur e dyshemesë duhet të stabilizohet deri në përfundimin e strukturës së re mbështese.

### **Prishja dhe transponimi i zgarave metalike dhe elementeve të tjera metalikë**

Prishja, dhe prerja e zgarave metalike dhe elementeve të tjera metalikë (si psh. elementeve strukturalë) dhe zhvendosja e tyre brenda kantierit duke përfshirë seleksionimin dhe stokimin e tyre brenda kantierit për ripërdorim do të përcaktohet ngalinxhinieri i zbatimit.

Bulonat fiksues (prizhonierët) duhet të priten rrafsh me betonin në mënyrë që të mundësohet mbulimi me metodat përkatëse. Sipërfaqet e rifiniturës që do të janë pjesë e ndërtesës së re duhet të riparohen në mënyrën e duhur estetike.

## **PRISHJA E RIFINITURAVE TË DYSHEMESË DHE RIFINITURAVE TË TJERA**

### **Identifikimi i rifiniturave që do të prishen**

Prishja e rifiniturave ekzistuese duhet të realizohet në përputhje me dokumentet e projektit ose duke ndjekur specifikimet e materialit të rifiniturës. Nese kërkohet që të hiqen të gjitha materialet e lirshme nëntokësore, kontraktori duhet të testojë sipërfaqet me kujdes me çekiç. Inxhinieri mund të kërkojë kryerjen e testeve të forcës në térheqje për rastet kur testimi me çekiç jep rezultate të diskutueshme.

### **Prishja e rifiniturave**

Të gjitha rifiniturat e dyshemesë që janë identifikuar për tu prishur, do të shkatërrohen me dorë ose duke përdorur makineritë e duhura në mënyrë që të mos dëmtohen elementet strukturore të bazamentit ose muraturat. Materiali i dëmtuar duhet të zëvendësohet nga i njëjti material ose material i një cilësie më të lartë dhe i përshtatshëm estetikisht. Aty ku ndonjë element strukturor ose i rifiniturës është i dëmtuar, i gjithë elementi duhet të zëvendësohet. Aty ku bëhen vetën

arname të rifiniturave me stuko ose suva, punët përgatitore duhet të sigurojnë një lidhje të mirë midis pjesëve ekzistuese dhe atyre të reja.

## **ELEMENTËT DHE STRUKTURAT E KONTAMINUARA**

### **Elementët dhe strukturat e kontaminuara**

Kontraktori duhet të menaxhojë të gjitha elementet dhe strukturat të cilat janë identifikuar si të kontaminuara (p.sh. nga nafta, kimikatet apo substancat e tjera të rrezikshme), sipas llojit të kontaminimit në përputhje me rregulloret lokale.

### **Toka e kontaminuar**

Toka nën strukturat e kontaminuara duhet të vlerësohet nga një specialist i licencuar për të përcaktuar nivelin e ndotjes dhe nëse është e nevojshme të spastrohet dukë gërmuar deri në 0.5m nën nivelin më të ulët të strukturave të prishura dhe të transportohen jashtë kantierit në pikat e specializuara të grumbullimit dhe detoksikimit.

### **Prishja/taposja e puseve ekzistuese**

Të gjitha instalimet e puseve mbi nivelin sipërfaqësor dhe instalimet nëntokësore deri në 1,0 m nën nivelin e tokës duhet të hiqen. Të gjitha instalimet elektrike duke përfshirë "pjesët e bashkimeve duhet të hiqen. Vrima e puseve duhet të taposen para se të mbulohet. Mbushja dhe nivelimi i tokës do të bëhet në përputhje me 2.

### **Prishja e instalimeve sanitare dhe hidraulike**

Pajisjet ekzistuese dhe instalimet sanitare si banjat, lavamanët, galizhanët, rubinetat e ujit, dushet, etj, duhet të çmontohen. Të gjitha vrimat e mbeturë në muret dyshemetë dhe tavanet duhet të mbullen.

### **Heqja e elementeve**

Pjesët ekzistuese prej alumini, apo prej plastike, apo fasadat e xhamit, dritaret, dyert dhe kornizat e dyerive duhet të çmontohen. Të gjitha pajisjet e çmontuara dala duhet të priten në një thellësi që tillë që të mundësojë mbulimin e tyre nga finitura specifike në atë vend.

### **Heqja e gardheve dhe e portave**

Gardhet ekzistuese dhe portat duhet të çmontohen së bashku me themellet e këtyre strukturave (siç specifikohet ose siç udhëzohet nga Inxhinieri mbikqyrës). Atu ku gardhet janë të bashkangjitura me ndërtesat apo strukturat ekzistuese referojuni 1.4.5 dhe 1.4.10. Pas gërmimit të themeleve duhet bërë mbushja dhe nivelimi nga ana e Kontraktorit ne përputhje me kapitullin 2.

### **Prishja e struktureve rrugore ekzistuese dhe rifiniturave**

Prishja e rrugës ne të gjithe trashesine apo pjesë të saj duhet të kryhet me pajisje të përshtatshme.

Prishja duhet të përbahet në mënyrë rigorozë për trashësinë e përcaktuar në projekt ose të përcaktuar nga Mbikëqyrësi. Sipërfaqet e skarifikuara duhet të janë krejtësisht te rregullta pa ndërprerje që mund të ndikojnë në përputhshmërinë e shtresave të reja; skajet e zonës frezuar duhet të janë vertikale, te drejta dhe pa shkermojje.

## **2 - PUNIME GERMIMI DHE MBUSHJE**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **KËRKESA TË PËRGJITHSHME**

Referencat: Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi. Botimet janë të referuara vetëm me emertimin e tyre.

### **LIGJET DHE NORMAT E APLIKUESHME SHQIPTARE**

#### **Standardet dhe normat e aplikueshme nderkombetare**

(Shoqata Amerikane për Testimin e Materialeve (ASTM) Publications):

D 698-78 Marrëdhënia Lagështi-Densitet i dherave - Përzierjet e Aggregateve duke

Përdorur çekiç 2.49 Kg nga një lartësi 305 mm

D 1556-74\_Densiteti i Tokës me Metodën e Konit të Rërës

D 1557-78 Marrëdhënia Lagështi-Densitet i tokës - Perzierjet e Aggregateve duke Përdorur çekiç 10 4.54 kg nga një lartësi 457mm

D 2922-81\_Densiteti i Dherave dhe Aggregateve në Terren me Metodat Bërthamore.

### **DORËZIMET**

#### **Raportet e testeve laboratorike të certifikuara**

Para dorëzimit të materialeve, tri kopje të certifikuara të raporteve të të gjitha testeve të kërkua të duhet t'i dorëzohen Inxhinierit të zbatimit për miratim. Testime shtesë do të kërkohen kur ka ndryshime të burimit nga vijnë materialet. Raportet e testeve të certifikuara janë të nevojshme për:

Mbushjen dhe nivelimin

#### **Planet e furnizimit, vizatimet e projektit dhe certifikimet**

Të gjitha gjërmimet e kanaleve mbi 2.5 metra të thella, apo gjërmimnet në tokat ku dihet se mungon stabiliteti i shpateve anësore, do të pajisen me pajandues. Pajandimet do të mbahen për sa kohë që vazhdon gjërmimi - Kontraktori duhet të paraqesë:

#### **Planet e Pajandimit**

Këtu do të përfshihet Lista e Materialeve që do të përdoren në sistemin e pajandimit, dhe komponentët që do të mbeten pas rimbushjes, planet, skicat, ose detajet së bashku me llogaritjet nga një inxhinier profesional i regjistruar për të gjitha gjërmimet madhore, dhe rradha dhe mënyra e instalimit dhe e çmontimit të pajandave.

## Planet e Tharjes

Këtu do të përshkruhet metoda për largimin e ujit mbledhur në kanalet e hapura dhe devijimin e ujërave sipërfaqësore apo ujit të pijshëm nga zonat e punës. Përshkrimi i pajisjeve dhe procedurave për instalimin dhe operimin e sistemit të tharjes. Përshkrimi i komponentëve kryesorë të sistemit të propozuar të tharjes, dhe performanca dhe efektiviteti i metodës apo sistemit të përdorur.

## PËRKUFIZIME

### Dheu vegetativ

Dheu vegetativ mund të përbëhet nga materialet e gërmuara, formacionet e pashqetësuara, dherat e imta, materialet sipërfaqsore dhe pjesa e dekompozuar organike. Dherat vegetative mund të kenë ngjyrë të errët, janë të imta, më përmbajtje rëre apo argjile dhe përmbajtje të lartë të lëndëve organike. Ato dhe shpesh përmbajnë gjurmë të materialit prejardhës. Dheu vegetativ duhet të përfaqësojë tokat produktive në afërsi të kantierit.

### Materialet e forta

Këto përfshijnë shkëmbinjtë e dekompozuar, tokat e dendura të konsoliduara, dhe konglomeratet të cilat nuk përfshihen në formacionet shkëmbore, por që kërkojnë pajisje të rënda gërmimi si eksavatorë dhe matrapikë.

### Materiale të padeformueshme

Këto përfshijnë shkëmbinjtë apo tokat e përziera me gurë që ndodhen në fund të kanaleve që kanë nevojë për mbulimin me materiale të imta apo shtresa speciale për të shmangur dëmtimin e tubacioneve.

### Materialet e papërshtatshme

Këto përfshijnë dherat apo materialet e tjera që nuk kanë fuqi apo stabilitet të mjaftueshëm për të suportuar ngarkesat e projekta. Gjithashtu në këtë grup bëjnë pjesë materialet e ndotura, material e ngrira, ato që përmbajnë gurë të mëdhenj dhe materiale të tjera që nuk e lejojnë dheun të kompaktësitet.

### Materialet e paqëndrueshme

Këto përfshijnë materiale që janë të identifikuar si të përshtatshme, por që më vonë janë prishur dhe saturuar.

### Dherat e huazuara

Këto janë dhera që janë sjellë nga diku tjetër. Kontraktori duhet ti sigurojë këto dhera me shpenzimet e tij.

### Dherat mbushës

Këto janë materialet e gërmuara që mund të përdoret për rimbushjen e kanaleve apo gropave. Këto dhera duhet të jënë pa gurë, pa pjesë të huaja apo substabca të dekompozuara, dhe pa argjila.

### **Shtresa e ashpër**

Këto janë shtresa dheu që vendosen sipër shtresave bazale, ose dhera që përdoren për mbushje dhe nivelim.

### **Kompaktësimi**

Kjo nënkupton çdo metodë që bën stabilizimin mekanik të një materiali nëpërmjet rritjes së dendësisë në kushte të kontrolluara lagështimi. "Shkalla e kompaktësimit", shprehet si një përqindje e densitetit maksimal të përcaktuar në laborator.

### **Informacioni mbi terrenin**

Është e kuptueshme se Klienti nuk do të jetë përgjegjës për çdo interpretim ose konkluzion të nxjerrë nga raportet gjeoteknike. Të dhënat e vëna në dispozicion janë thjesht në të mirë të Kontraktorit. Shpime të tjera investigative dhe operacione të tjera eksploruese mund të kryhen nga Kontraktori, me kusht që këto operacione të aprovojen nga Inxhinieri.

### **Furnizimet publike ekzistuese**

Vendndodhja e furnizimeve publike ekzistuese është e përafërt. Kontraktori duhet të verifikojë fizikisht vendndodhjen dhe nivelin nën tokë të tubacioneve të furnizimeve publike ekzistuese para se të fillojë procesin e ndërtimit. Kontraktori duhet të koordinojë me Inxhinierin për gjetjen e furnizimeve publike ekzistuese. Aprovimi për gërmimet do të merret nga të gjitha kompanitë përkatëse dhe një kopje duhet t'i jepet Inxhinierit.

### **Magazinimi i materialeve**

Materiali i gërmuar që është i kualifikuar si i përshtatshëm për tu përdorur si material mbushës do të depozitohet në kantier dhe do të ruhet aty deri sa të jetë e nevojshme. Ky material do të seleksionohet do të ruhet për të parandaluar kontaminimin dhe shpërbërjen e tij. Materiali i nuk duhet mbajtur shumë pranë buzës së gërmimeve por në një distancë të mjaftueshme për të parandaluar rënien e tij në gropën e gërmimit. Ndërkohë materialet e gërmuara që janë klasifikuara si të papërshtatshme si plehrat, mbeturinat dhe dherat e ndotura, do të largohen nga kantieri drejt pikave të grumbullimit të tyre sipas udhëzimeve të Inxhinierit.

### **Kërkesa të përgjithshme**

Ekzekutimi do të bazohet në faktorët e mëposhtëm:

Nivelet e sipërfaqes janë siç tregohet në vizatimet.

Nuk pritet që të zbulohen tubacione apo pengesa artificiale, me përjashtim të atyre që janë identifikuar.

Nuk pritet të vërehen materiale të forta.

Nivelet e ujraleve nëntokësore të paraqitura në vizatimet e shpimeve gjeoteknikë tregojnë thjesht nivelet në kohën kur u kryen shpimet dhe jo domosdoshmërisht nivelin e ujraleve nëntokësore në momentin e gjermimit.

Në rast se kushtet aktuale ndryshojnë në thelb nga ato të deklaruara apo të paraqitura, duhet të zbatohen dispozitat e kontratës që shpjegojnë strategjinë e veprimit për kushtet e ndryshuara. Materialet e forta do të konsiderohen shkëmbinjtë solidë, masat çimentuara të pa-stratifikuar, apo depozitat e konglomeratëve që posedojnë karakteristikat e shkëmbinjve të fortë të cilët kërkojnë operacione shpimi dhe shpërthimi për tu gërmuar. Edhe gurët masivë, muraturat, dhe copat solide të betonit që janë më të mëdha se 0.4 metra kub, mund të konsiderohen materiale të forta.

## EKZEKUTIMI

### PËRGATITJA E SIPËRFAQES

#### **Magazinimi i dheut të punueshëm**

Dheu i punueshëm do të merret nga shtresat sipërfaqesore gjatë punimeve të gjermimit dhe nivelimit dhe do të magazinohet në një vend të veçantë brenda kantierit. Materialet që nuk janë të përshtatshme të përdoren së bashku me dheun e punueshëm do të transportohen jashtë kantierit drejt pikave të caktuara të grumbullimit. Dheu i punueshëm do të vendoset atje ku mund të përdoret lehtësish për nivelimin e terrenit. Nëse dheu i punueshëm i nxjerrë nga kantieri nuk mjafton, Kontraktori do të sjellë dhera të huazuara. Materialet e marra nga jashtë kantierit duhet të stokohen në vende të caktuara.

Dherat mbushës nuk duhet të stokohen shumë pranë buzës së gjermimeve siç përmendet edhe në paragrafin 2.2.2.8.

### GËRMIMI

#### **Të përgjithshme**

Gërmimi përfshin gërmimin dhe largimin e materialeve të gërmuara për të arritur nivelin e caktuar të shtresës bazale.

Të gjitha gërmimet mund të kryhen me makineri, përvèç atyre që janë në zonat e brendshme të tillë si bodrumet të cilat do të kryhen në mënyrë manuale.

#### **Heqja e materialeve të forta**

Inxhinieri duhet të njoftohet menjëherë me shkrim, nëse del e nevojshme për të hequr shkëmbinj, ose materiale të vështira, të paqëndrueshme, ose në një thellësi më të madhe se sa specifikohet. Inxhinieri duhet të njoftohet menjëherë nëse gjatë gjermimit linjat e furnizimeve publike nuk rezultojnë në vendin e përcaktuar nga vizatimet e ndërtimit.

#### **Mbrojtja e njerëzve dhe pasurisë publike**

Të gjitha gërmimet duhen rrëthuar me barrikada dhe shenja paralajmëruese për sigurinë e personave. Dritat paralajmëruese duhet të sigurohen gjatë orëve të errësirës. Strukturat, tubacionet e furnizimeve publike, trotuaret, dhe objektet e tjera afër gjermimeve duhet të mbrohen nga dëmtimet që mund të vijnë nga cedimi, lëvizjet anësore, shembjet, dhe shpëlarja e

tokës. Barriera duhet të vendosen për të shmangur ngarkim-shkarkimet e automjeteve në afërsi të gërmimeve. Shenja paralajmëruese duhet të vendosen në buzë të gërmimeve për të shmangur afrimin e automjeteve buzë gërmimeve të hapura.

### **Gërmimi për strukturat**

Gërmimet për strukturat duhet të bëhen në përputhje me dimensionet dhe vendet e përcaktuara me një tolerancë prej plus ose minus 15 centimetra dhe do të shpërhapen në një distancë të mjaftueshme nga plintat dhe themelet për të lejuar një hapësirë adekuate të punës prej të paktën 50 cm për procese si; vendosja dhe heqja e kallepeve të betonit, kryerja e punëve të ndërtimit, dhe inspektime. Në gërmimet për plintat dhe themelet, duhet treguar kujdes që të mos preket pjesa e poshtme e gërmimit. Në përgjithësi 10 cm e fundit të gërmimeve do të bëhen pak para vendosjes së shtresës së betonit të varfër.

### **Gërmimi i kanaleve**

Gërmimet e kanaleve kryhen për hapjen e themeleve, për tubacionet e furnizimeve publike, dhe për tubacionet e vetë objektit. Anët e kanaleve duhet të janë pothuaj vertikale përvèç rasteve kur pjerrësia e shpateve është e specifikuar.

### **Gërmimi për rrugët**

Këto gërmime konsistonëz në hapjen dhe nivelimin e terrenit për rrugët dhe trotuaret. Të gjitha materialet e papërshtatshme do të hiqen, pavarësisht nga karakteri, deri në nivelin e përcaktuara dhe në përputhje me zonat, nivelet, seksionet tërthore dhe dimensionet e përcaktuara në vizatim. Materialet e papërshtatshme që kanë dalë nga operacionet e gërmimit dhe nivelimit do të zëvendësohen me materiale të tjera.

### **Gërmimi i paautorizuar**

Gërmimet përtej thellësisë apo përtej dimensioneve të specifikuara që nuk janë autorizuar nga Inxhinieri i zbatimit do të zëvendësohen pa ja transferuar kostot Klientit. Gërmimet e paautorizuara nën plintat apo themelet duhet të rimbushen me beton të varfër deri në nivelin e specifikuar pa krijuar ndryshime të projektit. Me përjashtim të këtyre rasteve, gërmimet e paautorizuara do të mbushen dhe kompaktësohen njëloj si gërmimet e tjera të të njëjtë klasifikim.

### **Stabiliteti i gërmimeve**

Shpatet e gërmimeve me thellësi mbi 2.5 m duhet të janë të pjerrët sipas këndit të fërkimit të materialit të gërmimit, ose përndryshe do të pajandohen dhe përforcohen aty ky nuk është e mundur të ruhet pjerrësia e shpateve për shkak të hapësirës së ngushtë, ose për shkak të stabilitetit të materialeve të gërmuara. Anët dhe shpatet e gërmimeve duhet të sigurohen deri në rimbushjen e tyre nëpërmjet shkallëve, platformave, ose mbështetësve anësorë.

Masa paraprake duhet të ndërmerren për të parandaluar rrëshqitjet ose shembjet në ato raste kur zonat përbri gërmimeve i nënshtrohen vibracioneve që krijohen nga trafiku i automjeteve, operimi i makinerive, apo ndonjë burim tjetër.

Materiali i gërmuar nuk duhet të stokohet pranë buzës së hendekut më afër se një e treta e thellësisë kanalit. Për kanalet pa pajandime, kjo distancë do të varet nga thellësia e gërmimit, përbajtja e lagështisë, forca kohezive e dheut, dhe profili i gërmimit. Në përgjithësi, materiali i gërmuar duhet të vendoset jashtë këndit 45 gradë që fillon nga dyshemeja e gërmimit.

### **Pajandimi dhe mbështetja**

Materialet e përdorura për pajandimin dhe mbështetjen, të tilla si fletët metalike, trarët vertikale, trarët horizontale dhe kllapat mbajtëse duhet të janë në gjendje të mirë pune. Të gjithë trarët duhet të janë pa nyje të mëdha. Pajandimi dhe mbështetja e gërmimeve do të bëhet pavarësisht nga koha për të cilën gërmimet qëndrojnë të hapura. Të gjitha pajandimet dhe mbështetjet do të kryhen në paralel me gërmimet. Nëse heqja e pajandimit mund të çojë në shëmbjen e shpatit anësor të tokës, atëherë mund të përdoren fletët metalike ose trarët prej kreosoti të presuar të cilat mund të lihen në vend pasi sharrohen në lartësinë e kërkuar.

### **Thithja e ujit**

Gërmimet do të kryhen në një mënyrë që të shmangin rrjedhjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore brenda hapësirës së gërmimeve dhe përbajtjen e kantierit dhe të terrenit përreth. Uji nuk duhet të lejohet të grumbullohet brenda gërmimeve.

Ujrat do të hiqen nga gërmimet nëpërmjet metodave të miratuarës në mënyrë që të mos ndodhë zbutja e bazës së themeleve, shkurtimi i pilotave, dhe ndryshime të tjera që çojnë në hubje të stabilitetit të shtresave nëntokësore. Pompat e thithjes, linjat e shkarkimit, dhe komponentët e tjerë të sistemit të tharjes do të përdoren për të nxjerrë ujin nga gërmimet. Operacionet tharjes së ujit do të janë të vazhdueshme deri në rimbushjen përfundimtare, ose derisa strukturat që ndikohen nga presioni i ujit kanë arritur fuqinë e tyre të plotë të specifikuar. Në të gjitha rastet, operacionet e tharjes do të vazhdojnë për aq kohë sa uji mund të hyjë apo të grumbullohet brenda gërmimeve. Uji i larguar nga gërmimet dhe uji i shiut do të përcillen nëpër kanalet e shkarkimit të miratuarës nga Inxhinieri. Kanalet e përkohshme të kullimit dhe objektet e tjera do të ndërtohen për çdo strukturë. Nuk lejohet përdorimi i kanaleve për tubacionet e furnizimeve publike si kanale kulluese qoftë edhe përkohësisht.

### **MBUSHJA DHE NIVELIMI**

#### **TË PËRGJITHSHME**

Mbushja konsiston në hedhjen e dherave të specifikuara brenda zonave të gërmuara në formë shtresash derisa të arrihet niveli i specifikuar. Nivelimi nga ana tjetër konsiston në vendosjen e materialit mbushës në formë shtresash derisa të arrihet niveli i përcaktuar për secilën nga zonat e klasikuara më poshtë:

#### **Materialet mbushës dhe nivelues**

Materialet që përdoren për mbushje dhe nivelim duhet të jetë pa plisa argjilore, dhe pa gurë apo zhavorre më të mëdhenj se 6 centimetra. Mbushja do të bëhet në mënyrën dhe sekuencën që siguron kullimin e duhur dhe në të gjitha kohët. Mbetjet e ngurta, materialet e ngrira dhe

materialet e tjera të dëmshme të çdo dimensioni do të hiqen. Materialet mbushëse dhe nivelueset duhet të jenë si më poshtë:

Zona	Materiali Mbushës dhe Nivelues
Në të gjithë gërmimet, përveç zonave më poshtë	Material i gërmuar ose i huazuar që është testuar dhe aprovuar si “Material i Përshtatshëm”.
Poshtë Ndërtesave	Material mbushës poroz
Poshtë Trotuareve	Material i gërmuar ose i huazuar që është testuar dhe aprovuar si “Material i Përshtatshëm”
Poshtë Rrugëve	Material agregat, i gërmuar apo i huazuar që është testuar dhe është aprovuar si “Material i Përshtatshëm”.
Poshtë zonave me bimësi	Material agregat, i gërmuar apo i huazuar që është testuar dhe është aprovuar si “Material i Përshtatshëm”.

### Përgatitjet para mbushjes

Gërmimet do të mbushen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo pa u plotësuar sa vijon:

- Miratimi i ndërtimit poshtë nivelit zero.
- Inspektimi, testimi, miratimi, dhe regjistrimi i vendndodhjes së objekteve të furnizimeve publike nëntokësore.
- Heqja e kallëpeve të betonit.
- Heqja e pajandave, dhe rimbushja e hapësirave me dhera të përshtatshme. Pajandat e përkohshme prej çeliku poshtë strukturave dhe tubacioneve të furnizimeve publike duhet të sharrohen dhe të hiqen në një mënyrë që parandalojnë cedimin e strukturës.
- Largimi i plehrave dhe mbetjeve të ngurta.

### Përgatitja e sipërfaqeve të tokës para mbushjes

Bimësia, mbeturinat, materialet e papërshtatshme, pengesat, dhe materialet e dëmshme do të hiqen nga sipërfaqja e tokës para mbushjes. Shpatet me pjerrësi 1 me 4 (1 njësi vertikal me 4 njësi horizontal) do të plugohen në mënyrë që materiali mbushës të lidhet me materialin ekzistues. Kur densiteti i sipërfaqes së tokës është më të ulët se ai i specifikuar, sipërfaqja e tokës do të plugohet, dhe do të laget për të arritur lagështinë optimale për kompaktësimin e mëtejshëm dhe për arritjen e dendësisë së nevojshme.

### Mbushja e kanaleve

Kanalet duhet të mbushen me kujdes me materiale të specifikuara, që do të depozitohen në shtresa, trashësia maksimale e të cilave në gjendje të shkrifët duhet të jetë 15 centimetra. Materialet e huazuara do të merren nga burime të miratuaras jashtë kantierit. Gjetja e dherave të huazuara do të jetë përgjegjësi e Kontraktorit. Materialet për mbushjen e tubacioneve të

furnizimeve publike do të hidhet në mënyrë të barabartë në të dy anët e tubacioneve përgjatë gjithë gjatësisë së tyre dhe më pas do të ngjeshen dhe do të mbushen përsëri derisa niveli të arrije të paktën 30 centimetra mbi tubacionet. Kujdes duhet të tregohet që të mos dëmtohen tubacionet gjatë mbushjes. Shirita identifikimi do të vendosen brenda kanalit mbi nivelin e tubacioneve për të mënjanuar dëmtimin e tyre aksidental në të ardhmen. Pjesa e mbetur e materialit mbushës do të depozitohet më pas në shtresa të shkrifta maksimumi 30 centimetra të trasha dhe do të kompaktësohet me vegla dore ose vibratorë mekanike. Kanalet dhe gropat që nuk janë kompaktësuar në mënyrën e duhur dhe për rrjedhojë kanë pësuar cedime të nivelit të tokës, duhet të rigërmohen në thellësinë e nevojshme dhe të rimbushen dhe kompaktësohen deri në arritjen e nivelit të përcatuar të densitetit.

Për të parandaluar humbjen e materialeve nëpërmjet efekteve të kullimit në shtratin e gërmimeve në ato kanale që janë në një terren të pjerrët, do të instalohen barriera prej argjile në të gjithë gjerësinë e gërmimit të paktën 30 m në të dy anët e aksit të kanalit.

### **Përgatitja e shtresës bazale (tabani) për rrugët**

Mbas nivelimit të plotë, dhe para se të depozitohet materiali sipërfaqsor, duhet të krijohet shtresa bazale, sipas dimensioneve, niveleve, dhe seksioneve tërthore të specifikuara. Të gjitha depresionet duhet të eleminohen për të kriuar një sipërfaqe uniforme. E gjithë shtresa bazale do të kompaktësohet nëpërmjet rrulave mekanikë. Ky proces do të përfshijë edhe njomjen e sipërfaqes për të arritur lagështinë optimale për një kompaktësim më të mirë. Të gjitha pjesët e buta, sfunjjerore, ose ato që epen nga shtypja do të hiqen dhe do të rimbushen me material më të përshtatshëm dhe do të kompaktësohen përsëri. Në ato zona mbi të cilat do të shtohet çakëll ose stabilizant pjesa e sipërme e shtresës bazale nuk duhet të ketë devijim më të madh se 12 milimetra. Shtresa e materialit granular (çakullit) duhet të shkojë përtej limiteve të stabilizantit apo asfaltit për të paktën 30 cm. Shtresa bazale duhet të mbahet në gjendje të përfunduar derisa të vendoset shtresa e parë e materialit granular (çakullit).

### **Përgatitja e zonave vegjetative**

Zonat e bimëzuara do të sheshohen në mënyrë uniforme sipas dimensioneve, niveleve, dhe seksioneve tërthore të specifikuara në vizatimet. Dhjetë centimetrat e parë pranë sipërfaqes duhet të janë të përbëra nga dhera të buta, të cilat duhet të ngjeshen lehtësisht. Të gjitha shtresat poshtë kësaj shtrese sipërfaqsore duhet të ngjeshen në mënyrë të ngjashme me shtresën bazale. Shtresa e punueshme do të shpërndahet në mënyrë uniforme në zonat e specifikuara me një trashësi mesatare prej 10 centimetresh dhe me një trashësi minimale prej 8 centimetresh. Para vendosjes së shtresës së punueshme, zonat ku shtresa bazale është ngjeshur së tepërti nga trafiku i automjeteve apo nga shkaqe të tjera, duhet të shkriftohet me disqe apo me lesa në në një thellësi prej të paktën 6 centimetresh për të lejuar ngjitjen e shtresës së punueshme me shtresën bazale. Shpërhapja e dheut të butë duhet të kryhet në mënyrë të tillë që mbjellja të mund të realizohet me pak lëvrim të tokës. Çdo parregullsi në sipërfaqe që rezulton nga nivelimi jo i mirë i dheut të butë duhet të korrigohet në mënyrë që të parandalohet formimi i gropave ku mund të

grumbullohet uji. Dheu i butë nuk duhet të hidhet kur baza është tepër e lagësht, ose jashtëzakonisht e thatë, ose çdo situatë tjetër që pengon nivelimin e duhur.

## KOMPAKTËSIMI

### TË PËRGJITHSHME

Kompaktësimi i dherave për mbushje dhe nivelimi do të kryhet me përdorimin e pajisjeve të specifikuara që janë të përshtatshëm për tokën që i nënshtronhet ngjeshjes dhe për zonën e punës. Kompaktësimi i dherave do të kontrollohet gjatë ndërtimit që të jetë në përputhje me densitetin e specifikuar për çdo zonë.

#### Pajisjet për kompaktësimin e dherave

Të gjitha pajisjet për ngjeshjen e dherave do të janë të një madhësie të përshtatshme dhe në gjendje të mirë pune për të përfunduar punën në afatin e caktuar. Pajisjet për ngjeshjen e dherave do të përbëhen nga rrula me dhëmbë, rrula pneumatike, tokmakë të thjeshtë, tokmakë vibrues, apo pajisje të tjera të përshtatshme për materialin specifik, dhe të aftë për të arritur densitetin e kërkuar të tokës në të gjithë shtresën që i nënshtronhet ngjeshjes.

#### Shtrimi dhe kompaktësimi i dherave

Materialet mbushës dhe nivelues do të shتروhen në shtresa jo më të trasha se 15 cm në gjendje të shkrifët. Para ngjeshjes, çdo shtresë e materialit mbushës apo nivelues duhet të laget ose të ajroset (të thahet) sipas nevojës për të siguruar lagështinë optimale. Materialet mbushës dhe nivelues do të ngjeshen në 95% të densitetit maksimal në një thellësi prej jo më pak se 25 cm për çdo zonë sipas specifikimit. Asnjë material mbushës dhe nivelues nuk do të hidhet mbi sipërfaqet që janë me baltë, të ngrira, ose që përmbajnë akull. Materialet mbushës dhe nivelues ngjitur me strukturat duhet të nivelohen mënyrë të barabartë dhe në të njëjtën thellësi me atë të materialit mbushës apo nivelues në zonat larg strukturës deri në arritjen e nivelit të specifikuar nëpërmjet kompaktësimit me tokmak dore ose me tokmakë vibrues pneumatikë. Materiali nivelues duhet të ngjeshet me tokmak vibrues të paktën dy herë.

#### Shkalla e kompaktësimit

Me përjashtim të rasteve ku specifikohet ndryshe, shkalla e kompaktësimit (densiteti i tokës) do të përcaktohet në përputhje me kërkesat e standartit ASTM D 698.

Përcaktimi në terren i densitetit të tokës do të kryhet sipas metodës së përshkruar në ASTM D 2922.

#### Kompaktësimi

Shtresat bazale të tokave duhet të arrijnë një densitet të paktën 95% të densitetit maksimal në një thellësi 25 centimetra nën nivelin e shtresës bazale. Materialet mbushës nën dyshemetë e betonit dhe në 30 centimetrat e para në zonat rrugore duhet të ngjeshen jo më pak se 95% e densitetit maksimal, ndërsa materialet mbushës ngjitur me strukturat apo që nuk suportojne elemente strukturale mund të ngjeshen të paktën deri në 90% të densitetit maksimal. Pjesa e sipërme e kanaleve të mbushura duhet të ngjeshet të paktën në 95% të densitetit maksimal.

## Kontrolli i lagështisë

Duhet të sigurohen pajisje që janë të afta për të shtuar sasi të matshme të lagështisë në shtresat sipërfaqsore siç përcaktohet nga testet që përcaktojnë raportin lagështi-densitet. Përbajtja e lagështisë në materialin e tokës gjatë procesit të kompaktësimit duhet të jetë plus ose minus dy për qind brenda asaj optimale. Për materiale të papërshtatshme të tokës, ku shtresa bazë është e kushtëzuar nga lagështia, sasia e kërkuar të ujtit do të aplikohet në mënyrë uniforme në sipërfaqe në mënyrë të tillë që të parandalohet shfaqja e ujtit të lirë në sipërfaqe gjatë ose pas operacioneve të kompaktësimit. Të gjitha materialet mbushës që e tejkalojnë nivelin optimal të lagështisë duhet të hiqen dhe të zëvendësohen me materiale më të përshtatshme. Materialet mbushës që janë më të lagësht se niveli optimal duhet të stokohen ose shpërhapen në sipërfaqen e Kantierit sipas udhëzimit të Inxhinierit dhe të thahen. Tharja mund të ndihmohet nëpërmjet gërmimit, dhe lesimit derisa lagështia të reduktohet në një nivel të kënaqshëm që përcaktohet nga testet e raportit lagështi-densitet, pas së cilës materiali mund të përdoret për mbushje apo nivelim.

## NIVELIMI

### TË PËRGJITHSHME

Të gjitha zonat brenda kufijve të përcaktuar duhet të nivelohen por edhe zonat e afërtë tranzicionale duhet të nivelohen në mënyrë uniforme. Sipërfaqja e përfunduar duhet të jetë e ngjeshur, dhe e sheshtë brenda tolerancave të specifikuara, si edhe duhet të mos ketë parregullsi sipërfaqësore.

### Zonat me bimësi

Sipërfaqja e zonave ku do të ketë bimësi, duhet të jenë jo më shumë se 3 cm sipër ose poshtë nivelit të zonës bazale.

### Zonat e trotuareve

Zonat e Trotuareve duhet të krijohen sipas formës, nivelit, dhe seksioneve tërthore të përcaktuara. Sipërfaqja e mbaruar duhet të jetë jo më shumë se 1-2 cm poshtë nivelit të zonës bazale.

### Zonat e rrugëve

Zonat e Trotuareve duhet të krijohen sipas formës, nivelit, dhe seksioneve tërthore të përcaktuara. Sipërfaqja e mbaruar duhet të jetë jo më shumë se 1-2 cm poshtë nivelit të zonës bazale.

### Largimi i materialeve nga kantieri

Mbeturinat, (ku përfshihen edhe materialet e gërmuara që janë klasifikuar si të papërshtatshëm, sasitë e tepërtë të dheut, dhe plehrat apo mbetjet e tjera të ngurta) do të hiqen nga kantieri, drejt vendeve të depozitimit dhe përpunimit pa kosto shtesë për klientin. Të gjitha lejet dhe tarifat për depozitimin e mbeturinave do të paguhen nga Kontraktori.

### Mbrojtja e zonave të niveluara

Zonat e apo niveluara duhet të mbrohen nga trafiku dhe erozioni dhe nga plehrat apo mbeturinat. Nëse ndodhin erozione, cedime të dheut, apo automjetet shkelin mbi zonën e niveluar, këto pjesë duhet të rinivelohen sipas udhëzimeve të Inxhinierit mbikqyrës.

### Rikondicionimi i zonave të ngjeshura

Atje ku zonat e ngjeshura janë prishur nga aktivitetet e mëvonëshme të ndërtimit, motit të keq, dhe arsyeve të njashme, sipërfaqja do të ripunohet dhe të kompaktësohet sipas specifikimeve të përmendura më sipër derisa të arrihet densiteti i nevojshëm. Pjesa e terrenit që ndodhet mbi kanalet e mbuluara të furnizimeve publike duhet të ringjeshet me tokmak dore.

## MOSTRAT DHE TESTIMI NË TERREN

### Testimi

Të gjitha testimet duhet të kryhen nga Kontraktori me shpenzimet e tij siç specifikohet në këtë manual.

### Granulometria

Përcaktimi i fraksioneve granulare duhet të bëhet për çdo mostër. Testi duhet të kryhet për çdo 100 m<sup>3</sup> material të përdorur apo fraksion i tij dhe kurdoherë kur ndryshon burimi i materialit.

### Testi i kompaktësimit

Testi i kompaktësimit duhet të kryhet në vendet e seleksionuara nga Inxhinieri si më poshtë:

Materialet	Shpeshtësia e Testimit
(1) Materialet mbushës	1 për shtresë për çdo 100 m <sup>2</sup>
(2) Shtresa bazale (testimi në vend)	1 për shtresë për çdo 800 m <sup>2</sup>
(3) Materialet mbushës për kanalet dhe rrugët	1 për shtresë për çdo 200 m kanal

### Mbrojtja e skrapatave

Gërmimet dhe hendekët e thellë duhet të mbrohen nga rrëshqitja. Shpatet e hendekëve të thellë për çdo gërmim varen nga cilësia e tokës dhe variojnë nga minimalisht 45° deri në 60° maksimalisht.

Nëse toka përmban minerale, të cilat për shkak të kontaktit me ujin humbasin stabilitetin, atëherë dheu dhe hendekët e thellë duhet të mbrohen mirë nga shiu, dhe të pajandohen dhe përforcohen sipas KTZ (Kushteve Teknikë të Zbatimit).

### Punimet e dheut gjate ngricave

Punimet e dheut mund të kryhen edhe gjatë dimrit kur temperaturat janë nën 0o C.

## PRODUKTET

### Mbushësit porozë

Bariera e ujit kapilar nën dyshemetë e betonit (e quajtura ndryshe mbushësit porozë) është përbëhet prej guri të pastër të grimcuar, prej zhavorri të grimcuar ose prej zhavorri të pa grimcuar, dhe 90-100 për qind e grimcave të tyre kalon nëpër sitën 20 milimetra ndërsa 0-5 për qind e e grimcave kalon nëpër sitën 4.75 milimetra. Ekuivalenti i rërës për këto materiale është jo më pak se 50. Materiale të tjera granulare që përbëhen nga një kombinim i duhur të rërës dhe gurëve të grimcuar mund ti përbushin kërkosat e mësipërme. Bariera e ujit kapilar duhet të vendoset drejtpërdrejt në shtresën bazale. Bariera do të ndërtohet në shtresa jo më të trasha se 10 centimetra në gjendje të ngjeshur, dhe çdo shtresa duhet të kompaktësohet me tokmak vibrues të paktën dy herë.

## DHERAT

### Toka e punueshme

Toka e punueshme duhet të mos ketë gurë më të mëdhenj se 3 cm dhe të mos ketë cungje pemësh, ferra, barëra të këqija dhe materiale të tjera që pengojnë rritjen e bimëve. Dheu i punueshëm do të sigurohet nga zona të aprovuara të furnizimit.

### Materialet mbushës të përshtatshëm

Materialet që janë të përshtatshëm për tu përdorur si mbushës për kanalet, dhe për gërmimet e themelive duhet të janë të ngjashme me terrenin përreth dhe të përbëhen nga rëra të thjeshta apo rëra të përziera me lym ose me argjila, të cilat nuk kanë mbeturina si rrënje, drurë, plehra dhe mbetje të tjera vegetale.

### Specifikat e materialit mbushës

Materiali Mbushës duhet të jetë i përbërë nga rëra apo gurë të thërrmuar (inerte) të thyer duhet të ketë gradimin e mëposhtëm të grimcave përbërëse:

Madhësia e Sitës	% e grimcave që e kalojnë sitën (sipas Peshës)
40 mm	90 deri 100
5 mm (No. 4)	25 deri 40
0.425 mm (No. 40)	0-10

### Rëra e lumenjve

Rëra duhet të jetë rërë natyrore lumi, e përbërë nga grimca të forta dhe të pastra, të qartanë ngjyrë dhe në formë sferike. Rëra duhet të jetë e pastër dhe pa substanca organike, lym, argjila, ose papastërti të tjera. Madhësia e grimcave të rërës duhet të jetë nga 0.5 mm deri në 1 mm.

### Materialet për shtresa

Materialet për shtresa duhet të janë rëra të imta dhe të ashpra me madhësi të grimcave nga 0 mm deri në 3 mm.

## PËRDORIMI I MATERIALEVE TË DALA NGA GËRMIMI

### Materialet e dala nga punimet e përkohshme

Materialet e përshtatshme që fitohen nga punimet e përkohshme mund të përdoren për mbushje. Çdo material i tepërt do të seleksionohet dhe pjesët e përshtatshme do të përdoren për mbushje.

### Materialet nga prishjet

Materialet prej guri dhe copat e muraturës së tullave që rezultojnë nga prishjet e përshkruara në sektionet e lartpërmendura mund të ripërdoren për mbushje. Ato duhet të janë të ngjeshura mirë, dhe të mos kenë pluhur, stuko dhe materiale organike. Inxhinieri mbikëqyrës duhet t'i kontrollojë të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet dhe nëse ato janë të përshtatshme mund të autorizojë përdorimin e tyre.

### Punimet e dheut dhe drenazhimi

Drenazhimi mund të instalohet në formën e rrjetit të drenazhit ose drenazhit në sipërfaqe. Për rrjetet e drenazhit mund të përdoren tubat plastikë, tubat prej betoni apo ato prej keramike. Tubat duhet të vendosen në vazhdim të kanaleve të drenazhimeve dhe të fiksohen dhe të nivelohen sipas kërkesës. Tubat duhet të vendosen mbas hapjes së kanalit të drenazhit dhe në një shtresë zhavorri të paktën 7 cm. Mbas vendosjes tubat duhet të mbulohen me një shtresë zhavorri ose rëre 10 cm të trashë për ta mbrojtur tubin. Më pas zona do të mbushet me dheun ekzistues ose dheun e sjellë nga jashtë.

Drenazhimi në sipërfaqe realizohet nëpërmjet hapjes së drenave dhe mbushjes së tyre me zhavorr. Drenat, sipas kërkesave, duhet të kenë sipërfaqe: 20x30, 30x40 ose 30x60 cm. Distanca midis tyre duhet të përcaktohet sipas koeficientit të filtrimit të tokës.

## 3 - RRUGËT, TROTUARET DHE SHESHET

### TË PËRGJITHSHME: PUNIMET E SHTRIMIT TË RRUGËVE TË TRANSPORTIT, DHE TË TROTUAREVE

#### Referencat

Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi. Botimet janë të referuara vetëm me emertimin e tyre.

#### LIGJET DHE NORMAT E APLIKUESHME SHQIPTARE

##### Standardet dhe normat evropiane

DIN 18315\_Procedurat e kontratave për ndërtimin punët - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për ndërtimin e punimeve; Punët ndërtimore për linjat e trafikut, shtresat e sipërme pa kordonë

DIN 18316\_Procedurat e kontratave për ndërtimin punët - Pjesa C: specifikimet e përgjithshme teknike për ndërtimin e punimeve; Punët ndërtimore për linjat e trafikut, shtresat sipërfaqsore me kordonë hidraulikë

DIN 18318\_ Procedurat e kontratave për ndërtimin punët - Pjesa C: Specifikimet e përgjithshme teknike për ndërtimin e punimeve; Punët ndërtimore për linjat e trafikut, gurët pllakat dhe bordurat e trotuareve

DIN EN 1338\_Kalldrëmet e betonit - Kërkesat dhe metodat e provës.

DIN EN 1342\_Kompletet e gurit natyror për shtrimin e ambienteve të jashtme - Kërkesat dhe metodat e provës

DIN EN 1343\_Bordurat e gurit natyror për shtrimin e ambienteve të jashtme - Kërkesat dhe metodat e proves

### Kërkesa të përgjithshme

Shtrimi i rrugëve në përgjithësi bëhet duke hedhur shtresa materialesh të përbëra nga aggregate të përziera me bitum të nxehtë, të cilat vendosen mbi një shtresë mikse aggregatësh të ngjeshura dhe të përzier me çimento, e cila nga ana e saj vendoset mbi një substrat me aggregate të përziera.

### Takimi paraprak

Para fillimit të punimeve duhet të mbahet një takim i përbashkët pune me pjesëmarrjen e Inxhinierit, Kontraktorit të përgjithshëm, dhe gjithë Nënkontraktorëve që do të merren me shtrimin e rrugëve, në mënyrë që të konfirmon planet e ndërtimit, shpatet e kërkua të kullimit, masat për kontrollin e trafikut, rradha e punës, kërkesat për sigurinë, shenjat paralajmëruuese dhe barrikadat, si edhe kërkesat e tjera që duhet të merren parasysh.

### Observimi paraprak i terrenit

Para se të fillojnë punët aktuale të shtrimit të rrugëve duhet kryer një observim i përgjithshëm paraprak i terrenit nga ana e Inxhinierit dhe Kontraktorit për të konfirmuar që:

Të gjitha kërkesat për ngjeshjen e terrenit janë plotësuar;

Nuk ka pengesa apo automjete të ngecura që mund të pengojnë punimet;

Preparimi i sipërfaqes është kryer dhe zona është e gatshme për hedhjen e shtresave të zhavorrit, stabilizantit dhe të shtresës së kalldrëmit.

### Përkufizimi i termave

Shtresa bazale: Kjo është shtresa existuese e terrenit ose materialit të importuar që është ngjeshur në mënyrën e specifikuar mbi të cilën do të shtrohen shtresat e tjera.

Shresa Nënbazë: Kjo është një shtresë me trashësi mesatare 20 cm prej guri të thyer dhe aggregatësh të përzier që për nga madhësia janë midis aggregatëve të shtresës bazale dhe stabilizantit.

Shtresa e Stabilizantit: Është një shtresë me trashësi 15 cm prej aggregatësh të përzier që shërben për të mbështetur shtresën e betonit.

Shtresa bituminoze e Binder-it: Shtresë me trashësi 5 cm, prej bitumi që ndodhet poshtë shtresës së asfaltit.

Shtresë betoni: Këto përbëhen nga një shtresë betoni të derdhur në vend me trashësi 10 cm e cila eshtë e armuar me një rrjetë prej çeliku me shufra 10 milimetërshe dhe me përmasa të kuadrateve të rrjetës 20 x 20 cm.

Shtresë niveluese llaç çimento: Kjo përbëhet nga një shtresë me llaç çimento me trashësi 4 cm të vendosura mbi shtresën e betonit.

Shtresë me pllaka guri: Kjo përbëhet nga një shtresë me pllaka guri me trashësi 8 cm të vendosur mbi shtresën niveluese llaç çimento.

## DORËZIMET

### Mostrat

Dorëzo mostrat e materialeve sipas direktivave të Inxhinierit. Në vend të mostrave aktuale mund të paraqiten çertifikatat e përputhshmërisë për materialet e listuara më poshtë të cilat duhen aprovuar nga Inxhinieri:

- Përzierjet granulare
- Përzierjet granulare të stabilizuara
- Agregatet (2 kilogram për çdo madhësi agregati nga secili lloj)
- Plakat e gurëve të shtrimit me kalldrëm
- Bordurat e gurit

### Raportet e testimeve

Para dorëzimit të materialeve, tre kopje të çertifikuara të raporteve të të gjitha testeve të nevojshme duhet t'i dorëzohen Inxhinierit për miratim. Testimet shtesë duhet të kryhen kur burimi ku merren materialet ka ndryshuar.

Të bëhet dorëzimi i raporteve e testeve për materialet e mëposhtëme:

- Përzierjet Granulare
- Përzierjet granulare të stabilizuara
- Agregatet minerale
- Betonet

## FURNIZIMI DHE RUAJTJA E MATERIALEVE

### Furnizimi dhe ruajtja e materialeve

Materialet duhet të dorëzohen në terren në paketën ose kontenierin e tyre original të pahapur. Paketa duhet të ketë etiketën e prodhuesit ku duhet të identifikohet qartë emri i prodhuesit, emri i markës, materiali, pesha ose vëllimi, dhe të gjitha informacionet e tjera në nevojshme. Materialet duhet të magazinohen në një vend të mbrojtur nga elementët atmosferikë, derisa të janë të gatshëm për përdorim.

Agregatet e pa paketuar duhet të ruhen në mënyrë të tillë që të shmanget shpërbërja e tepruar apo ndotja me materiale të tjera dhe me aggregate të madhësive të tjera. Shufrat e armimit duhet të magazinohen sipas madhësive të tyre në pirgje ose stiva të veçanta jo në kontakt me dyshemenë për të shmangur ndryshkjen e tepruar. Ato duhet të mbrohen nga ndotësit si yndyrat, vajrat, dhe balta. Duhet të sigurohen shenjat dalluese të sakta për identifikimin e tufave të shufrave të çelikut pasi janë hequr etiketat.

### Markimi i materialeve

Materialet duhet të dorëzohen dhe të ruhen në enë të mbyllura që tregojnë qartë emrin e caktuar, formulën ose numrin e specifikimit, datën e prodhimit, ngjyrën, emrin e prodhuesit, dhe udhëzimet e përdorimit, të cilat duhet të jenë qartësisht të lexueshme në kohën e përdorimit.

### **Menaxhimi i trafikut**

Qarkullimi i automjeteve nuk duhet të lejohet mbi rrugët e shtruara ku temperatura e sipërfaqes nuk është ftohur nën të paktën 50 gradë celsius dhe aty ku ngjeshja përfundimtare nuk është arritur. Temperatura e sipërfaqes duhet të matet me termometra të miratuara për këtë funksion. Barrikadat dhe shenjat e dukshme paralajmëruese duhet të vendosen në gjithë pikat e hyrjes në zonën e projektit për të paralajmëruar këmbësorët mbi qarkullimin e mjeteve dhe për operacionet e ndërtimit. Ndalohet përdorimi në vend të barrikadave i flamurëve apo shiritave të lehtë që mund ti marrë lehtësisht era. Barrikadat dhe shenjat paralajmëruese duhet t'i bëjnë ballë motit dhe të kryejnë funksionin e tyre edhe pas orëve të errësirës.

### **Testimet e materialeve**

Kontraktori duhet të kryejë testet e kërkuara në shtresat e zhavorrit (çakullit) dhe të stabilizantit për të konfirmuar përputhjen me nivelin e cilësisë së specifikuar.

### **Testimi i betonit per shtrimin e rrugeve dhe shesheve**

Testi i Sipërfaqes: Pas stazhionimit, sipërfaqja e betonit duhet të testohet me një mastar me gjatësi minimale 3 metra, për të zbuluar ndonjë parregullsi në sipërfaqen e betonit. Nëse vërehen difekte më të mëdha se 3 mm për çdo 3 m, ose më të mëdha se 6 milimetra për çdo 3 m në drejtim tërthor betoni duhet të korrigohet duke u rrashinuar ose duke u zëvendësuar me beton të ri nga e para.

## **EKZEKUTIMI: PUNIMET E SHTRIMIT TË RRUGËVE DHE TROTUAREVE**

### **Aplikimi i shtresës së nënbazës**

Materiali granular (çakulli) që do të merret nga guroret, duhet të shpërhapet në mënyrë sipërfaqsore në formë shiritash mbi sipërfaqen e rrugës. Për të arritur trashësinë e shtresës sipas specifikimeve të paraqitura në vizatimet e projektit, mund të ndiqet procedura e perzierjes për të arritur një homogenitet sa më të mirë duke përdorur një përzierës të motorizuar që e shpërhap materialin mbi sipërfaqen e rrugës në të njëjtën kohë që e hedh atë. Më pas nëse është e nevojshme materiali duhet që të laget në varësi të kushteve mjedisore, dhe të ngjeshet me rrula gome ose rrula vibrues për të arritur një densitet jo më të vogël se 95% e densitetit maksimal sipas testit të modifikuar të AASHTO's.

Shtresa e materialit duhet të jetë në konformitet me seksionet transversale dhe longitudinale të specifikuar në projekt.

### **Shtrimi i shtresës së stabilizantit**

Për procedurën e shtrimit të stabilizantit punimet do të kryhen në mënyrë të ngjashme me ato që kryhen për shtresën e zhavorrit por duke shtuar proceset e mëposhtme:

Çimentoja duhet të hidhet në mënyrë uniforme, në sasitë e përcaktuara në projekt, dhe në përputhje me kërkesat e Drejtuesit të Punimeve.

Uji duhet të hidhet në sasinë e duhur dhe duke përdorur spërkatës në mënyrë që të shpërhapet në mënyrë uniforme për të arritur lagështinë e duhur sipas kërkesës së Drejtuesit të Punimeve.

Mbas përzierjes uniforme të materialeve me çimenton kjo përzierje duhet të ngjeshet për të arritur densitetin e kërkuar nga Drejtuesi i Punimeve.

Përzierja duhet të mbahet e lagësht duke shtuar ujë në sasinë e nevojshme për të mbuluar humbjet e ujit gjatë punës, sipas udhëzimeve të Drejtuesit të Punimeve.

Mbasi është përfunduar shtrimi i shtresës së stabilizantit ajo duhet të mbulohet menjëherë me rërë dhe mushama, për një periudhë prej 7 ditësh, në mënyrë që të parandalohet humbja e lagështisë.

Proporcioni i çimentos në krahasim me materialet e tjera do të përcaktohet në bazë të karakteristikave të këtyre materialeve. Normalisht përqindja ndryshon nga 4 -14% të peshës së thatë ose nga 6 - 16% të vëllimit të ngjeshur.

## **EKZEKUTIMI I SHTRESËS SË BETONIT PER SHTRIMIN E RRUGEVE DHE SHESHEVE**

### **Transportimi i betonit të parapërgatitur**

Betoni i parapërgatitur duhet të furnizohet me kamionë përzierës dhe do të pranohet nëse është në përputhje me kërkesat e standardit DIN EN 206-1.

Prodhuesi i betonit të parapërgatitur duhet të paraqesë fletën e furnizimit për çdo ngarkesë betoni në dy kopje; njëra për Inxhinierin dhe tjetra për Kontraktorin. Përveç kërkesave të standartit DIN EN 206-1, fleta e furnizimit duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

- Tipi dhe marka e çimentos
- Përqindja e çimentos për çdo metër kub beton
- Madhësia maksimale e aggregateve
- Sasia totale e ujit e shprehur si raport Ujë/Çimento
- Numri i identifikimit të kamionit
- Volumi i betonit në kamion
- Koha e prodhimit

Betoni duhet të përzihet vazhdimesht dhe fleta e furnizimit duhet të kërkohet për çdo ngarkesë që është gati për tu përdorur. Përzierja e betonit duhet të fillojë brenda 30 minutash pasi çimentos i janë shtuar aggregatet.

### **Derdhja e betonit në kallëp**

Betoni duhet të hidhet në kallëp brenda 90 minutave nga përzierja e ujit me çimenton në qoftë se temperatura e ajrit është më pak se 30°C. Kjo kohë duhet reduktuar në 60 minuta në qoftë se temperatura e ajrit është më e madhe se 30°C. Uji mund të shtohet, me kusht që ulja e specifikuar e konusit (testi i konsistencës Abraham ose Slump Test) dhe raporti ujë/çimento nuk tejkalohen. Betoni nuk duhet të hidhet në kallëp nëse: (a) kushtet e motit pengojnë hedhjen e betonit dhe konsolidimin e tij; (b) zonat janë të pambuluara gjatë periudhave të reshjeve; dhe (c) kur uji është i

pranishëm brenda formës. Para hedhjes së betonit, duhen hequr papastërtitë, mbeturinat e ndërtimit, uji, bora dhe akulli nga betoformat.

### **Pompat e Betonit**

Betoni mund të transportohet me Pompa Betoni vetëm mbas aprovimit me shkrim nga Inxhinieri. Kontraktori duhet të paraqesë planin e tij të plotë të operimit nga koha e shkarkimit të betonit nga përzierësi deri në momentin e derdhjes dhe sistemimit të betonit brenda kallëpit. Pompa e betonit duhet të operohet dhe të mirëmbahet në mënyrë që të sigurojë një rrjedhë të vazhdueshme pa xhepa ajri, pa ndarje të aggregateve dhe pa ndryshime të uljes së konusit (slump test) me më shumë se 5 centimetra

### **Vibrimi i Betonit**

Menjëherë pas vendosjes, së çdo shtrese të betonit ai duhet të vibrohet me vibratorë të brendshëm dhe të sistemohet me mistri, shtizë apo tokmak druri. Tokmakët me dridhje apo çdo formë tjeter vibrimi nga jashtë nuk lejohen. Vibratorët nuk duhet të përdoren për të transportuar beton brenda kallëpeve. Vibratorët e brendshëm të zhytur në beton duhet të kenë një frekuencë minimale jo më pak se 8000 vibrime për minutë. Kohëzgjatja e vibrimit duhet të jetë jo më e gjatë se koha që prodhon konsolidimin e pranueshëm, që në përgjithësi është nga 5 deri në 15 sekonda. Vibratorët do të aplikohen në pikë uniforme 45 centimetra larg njera tjetrës.

### **Temperaturat e ulta**

Temperatura minimale e betonit duhet të ruhet mbi 10°C. Betoni nuk duhet të hidhet kur temperatura e ambientit është nën 5°C. Në rastet e temperaturave të ulta betoni duhet të mbulohet dhe të sigurohet me një burim i mjaftueshëm ngrohjeje për të ruajtur temperaturën mbi 10°C ndërkokë që betoni stazhionohet.

### **Temperaturat e larta**

Temperatura maksimale e betonit duhet të jetë jo më shumë se 32 gradë celsius. Ingredientët duhet të ftohen para se të përzihen ose mënyra të tjera duhet të përdoren për të kontrolluar temperaturën dhe për të shmangur tharjen e shpejtë të betonit. Betoni duhet të mbulohet dhe të kurohet apo sipërfaqja e betonit është mpiksur mjaftueshmërisht për të lejuar stazhionimin.

### **Fugat e betonit**

Fugat e betonit duhen krijuar në trotuarët dhe rrugët e shtruara me beton që kanë gjërsësi deri në 3.5 m. Fugat e kontrollit duhet të bëhen minimalisht çdo 3 metra.

## **SIPËRFAQJA E BETONIT**

### **Defektet**

Duhet të riparohen defektet në sipërfaqet e betonit duke i hequr plotësisht pjesët me defekt. Sipërfaqet e ekspozuara duhet të janë uniforme në pamje dhe të lëmuara, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe.

### **Finitura**

Betoni duhet punuar në sipërfaqe për të krijuar konturin, sipërfaqen e duhur pa lejuar të ndodhë ndarja e ujit nga agregatet. Betoni duhet lënë për tu mpiksur mjaftueshëm për të mundësuar manipulimin e sipërfaqes për t'i dhënë finiturën e duhur. Nuk lejohet hedhja e çimentos së thatë mbi sipërfaqen e njomë me qëllim tharjen e ujit të tepërt. Nuk duhet aplikuar beton nivelues mbi sipërfaqet që janë akoma të njoma për të krijuar një finitura të lëmuar. Mallat prej çeliku dhe mstritë duhet të përdoren për të krijuar finiturën e betonit para se betoni të ngurtësohet. Atje ku nuk ka kullues, sipërfaqja e dyshemeve duhet të jetë e sheshtë dhe disniveli nuk duhet të jetë më i madh se 6 mm për çdo 3 metra.

## KONTROLLI I CILËSISË NË TERREN

### Testet

Testet e mëposhtëm duhet të kryhen për të siguruar përputhjen me temperaturën, trashësitë, dhe kërkesat e densitetit të shtresave për të gjitha shtresat. Duhet të sigurohen të gjitha instrumentat, fuqia punëtore dhe materialet për kryerjen e testimeve dhe për riparimin e sipërfaqeve të rrugëve. Marrja e mostrave dhe testimet duhet të kryhen jo më rrallë se frekuanca e nevojshme për punën e çdo dite si edhe çdo herë kur ndodhin ndryshime në përzierjet ose materialet që përdoren. Testet e mëposhtme duhet të kryhen:

Testi i Dendësisë për shtresat e zhavorrit dhe nënshtresën e rrugëve:

ASTM D1556 ose D2922.

### Testi i Trashësisë

Duhet të kontrollohet trashësia e shtresës bazë, të shtresës nënbazë, të shtresës së binderit dhe të asfalto-betonit. Mostrat për përcaktimin e trashësisë së shtresës së përfunduar duhet të merren në prani të Inxhinierit. Një mostër për çdo 420 m<sup>2</sup> duhet të merret mesatarisht. Mangësia maksimale e lejueshme në çdo moment nuk duhet të kalojë 6 mm të trashësisë së specifikuar. Kontraktori do të korrigjojë zonat e gjetura mangët duke hequr shtresat në fjalë dhe duke i zëvendësuar me shtresa të reja.

### Testi i nivelimit

Përdor një mastar të drejtë me gjatësi 3m për të kontrolluar nivelin e sipërfaqes duke e vendosur në kënd të drejtë me aksin e rrugës mbas ngjeshjes përfundimtare. Devijimet e nivelit që janë më të mëdha se 1 cm centimetër duhet të korrigohen me heqjen apo me shtimin e materialit, riformimin e shtresës dhe ringjeshjen. Për shtresat e substratit dhe për ato të zhavorrit testi i nivelimit do të kërkohet vetëm për shtresat e sipërme.

### Rezultatet e testeve

Rezultatet e testeve do të përcillen si pjesë e "Raportit Ditor të Inspektimit". Sasitë totale të përzierjes (në Ton) që janë përdorur në projekt duhet të jetë gjithashtu pjesë e raportit ditor, duke përfshirë numrin e kamionëve, ose sasinë e përzierjes së përdorur për çdo ditë pune.

### Niveli i përfunduar

Niveli i përfunduar i çdo shtrese duhet të ndryshojë nga niveli relativ i përcaktuar në vizatimet e projektit me jo më shumë se 12 mm. Kontraktori duhet të korrigojë zonat e mangëta duke hequr punën ekzistuese dhe duke bërë zëvendësimin me materiale të reja që plotësojnë specifikimet, pa kosto shtesë për Klientin. Korrigjimi i zonave të ulëta nëpërmjet arnimit sipërfaqsor nuk do të lejohet.

## PRODUKTET: PUNIMET E SHTRIMIT TË RRUGËVE DHE TROTUAREVE

### Uji

Uji duhet të jetë i butë, i pijshëm dhe pa materiale inorganike si edhe pa komponime të klorurit të sulfatit që tejkalojnë përqindjet e përcaktura. Uji duhet të jetë pak alkalin me Ph midis 6 dhe 8. Uji nuk duhet të ketë më shumë se 2% (të peshës) materiale inorganike të pezulluara dhe më shumë se 15% materiale inorganike të tretura në formë solucioni. Uji nuk duhet të përbajë fare lëndë organike qoftë në formë të pezulluar apo në formë solucioni. Sulfatet nuk duhet të përbëjnë më shumë se 1 në 1000 të peshës. Uji i detit është i ndaluar.

### Aggregatët për shtresën e nënbazës (çakullit)

Për ndërtimin e shtresës bazale të rrugës është e nevojshme të përdoret një përzierje aggregatësh që fillojnë me argjilë ose lym me përmasa 0.074 mm deri në madhësinë e zhavorreve dhe gurëve me dimension maksimal prej 50 mm. Kurba e granulometrisë duhet të jetë brenda limiteve të përcaktuara nga linja Talbot. Shtresa duhet të ketë një indeks plasticiteti midis 6 and 9 (me përjashtim të situatave të veçanta kur limiti i plasticitetit mund të rritet në 10), me kusht që shtresat e sipërme të mos shpërbëhen dhe të realizohet një masë argjile dhe betoni me një përzierje të përshtatshme gurësh. Limiti i lagështisë nuk duhet të kalojë 35. Trashësia e shtresave të zhavorrit do të jëtë në funksion të rezistencës mbajtëse të shtresës bazë dhe ngarkesave të supozuara të të trafikut (maksimumi 8 kg/m<sup>2</sup>). Rezistenca mbajtëse përcaktohet nga testi CBR i rezistencës (California Bearing Ratio) mbi një mostër të ngjesur me dorë sipast metodës Proktor.

Niveli i pranueshëm i kualitetit të aggregatëve:

Fraksionet > 4mm:

C. Los Angeles (LA)	% ≤40
Dimensioni maksimal	mm63
Sensibiliteti nga akulli	% ≤30

Fraksionet ≤ 4mm:

Limiti i Lagështisë (WL)	% ≤35
Ekuivalenti i rërës (ES)	% ≤40
Indeksi i plasticitetit	% ≤6
Kalognë sitën 0.075	% ≤6

### Aggregatët për shtresën e stabilzantit

Për ndërtimin e shtresës së stabilizantit është e nevojshme të përdoret një përzierje aggregatësh që fillojnë me argjilë ose lym me përmasa 0.074 mm deri në madhësinë e zhavorreve dhe gurëve me dimension maksimal prej 30 mm. Kurba e gradimit duhet të jetë brenda limiteve të përcaktuara nga linja Talbot. Shtresa duhet të ketë një indeks plasticiteti midis 6 dhe 9 (me përjashtim të

situatave të veçanta kur limiti i plasticitetit mund të rritet në 10), me kusht që shtresat e sipërme nuk shpërbëhen dhe realizohet një masë argjile dhe betoni me një skelet të përshtatshëm prej gurësh. Në fund limiti i lagështise nuk duhet të jetë më i madh se 35. Trashësia e shtresave të stabilizantit do të jetë në funksion të rezistencës mbajtëse të substratit dhe ngarkesave të supozuara të trafikut (maksimumi 8 kg/m<sup>2</sup>). Rezistenca mbajtëse përcaktohet nga testi CBR i rezistencës (California Bearing Ratio) mbi një mostër të ngjesur me dorë sipast metodës Proktor.

### Niveli i pranueshëm i kualitetit të aggregatëve të stabilizantit

Frakcionet >4mm

C. Los Angeles (LA)	% ≤40
Abrazioni Micro-Deval	% ≤35
Dimensioni maksimal	mm30
Sensibiliteti nga akulli	% ≤30
Kalojnë sitën 0.075	% ≤2

Frakcionet ≤ 4mm:

Limiti i Lagështisë (WL)	% ≤35
Ekuivalenti i rërës (ES)	% ≤35
Indeksi i plasticitetit	% ≤6

### Shtresa e betonit të armuar për rrugët, trotuarët dhe sheshet

Rrugë, trotuarë dhe sheshet duhet të ndërtohen nga beton me rezistencë nominale 25 N/mm<sup>2</sup>, Klasa C20/25 me karakteristika si më poshtë:

### CILËSITË E BETONIT

#### Kërkesa të Përgjithshme:

Betoni duhet të ketë një rezistencë në shtypje minimale sipas tabelës së mësipërme dhe paragrafit 01, me përashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### Konsistenza e Betonit:

Testimi i konsistencës së betonit (testi i uljes së konusit Abrahams apo Slump Test) duhet të kryhet në përputhje me standartin DIN EN 12350-2.

Për tipin e betonit dhe përzierjen referoju dokumentave të ekzekutimit dhe rregullave të shprehura në standartin KTZ 37 – 75 "prodhimi i betonit".

Gjatë përgatitjes së betonit duhet të ndiqen rregullat e dhëna në kapitullin 6 "përgatitja e betonit" e KTZ 10 / 1-78, paragrafët 6.2, 6.3 dhe 6.4.

#### Agregatet lokalë

Betoni do të përbëhet nga rërë e ashpër ose pluhur guri, apo përzierje e tyre, dhe gurë të therrmuar nga guroret lokale. Të gjitha agregatet duhet të jetë pa argjila dhe pa papastërti të tjera. Agregatët duhet të janë afërsisht në formë kubike dhe jo sferike. Granulometria e aggregatit duhet të ketë çertifikatën e vendit nga ku ata janë marrë.

### Betoni i parapërgatitur në fabrikë

Në standartin DIN EN 206-1, betoni i parapërgatitur është përcaktuar si betoni i prodhuar rregullisht nga një institucion tregtar dhe që i dorëzohet blerësit në gjendje plastike. Betoni i parapërgatitur mund të përdoren me kusht që:

- Fabrika ka kapacitetin dhe pajisjet e duhura për të furnizuar betonin në markën e dëshiruar.
- Intervali midis dy ngarkesave për të njëtin kallëp nuk i kalon 30 minutat.
- Koha midis përzierjes së ujit me çimenton dhe agregatet, apo të çimentos me agregatet, si dhe vendosja e betonit në kallëp nuk kalon një orë.

Betonet e parapërgatitur, duhet të jenë të përziera dhe të furnizohen me anë të njërsës prej metodave të mëposhtme:

- Përzierja Qendrore:

Kjo nënkuption përzierjen e betonit plotësisht në një përzierës stacionar në fabrikë dhe transportimin e betonit të përzier në vendin e punës nëpërmjet një kamioni me betonier.

- Përzierja Tranzitore:

Në këtë rast përzierja kryhet në betonierin e kamionit. Përzierësit dhe agijitorët do të operohen brenda kufijve të kapacitetit të tyre dhe të shpejtësisë së rrotullimit të paracaktuar nga prodhuesi. Ato duhet të jenë të aftë për të riprodhuar një përzierje homogjene dhe ngjyrë uniforme. Përcaktimi i peshës dhe lagështisë është përcaktuar brenda këtij dokumenti.

### Çimentoja

Lloji i çimentos do të zgjidhet në përputhje me DIN EN 197-1 dhe DIN EN 206 Shtojca D. Kontraktori do të furnizojë me çdo ngarkesë të çimentos një kopje të faturës duke dekluaruar sasinë dorëzuar, emrin e prodhuesit dhe gjithashtu çertifikatën e prodhuesit ku tregohet se çdo dërgesë është testuar, analizuar, dhe përputhet me standardet. Çimentoja do t'i nënshtrohet testeve të tilla standarde që Inxhinieri i konsideron të nevojshme dhe ai mund të refuzojë çdo çimento, e cila provohet të jetë e papërshtatshme pavarësisht çertifikatës së prodhuesit.

### Uji

Uji duhet të jetë i freskët, i pastër dhe i pijshëm. Përbajtja e ujit duhet të jetë brenda kufijve të DIN EN 206.

### Agregatet

Agregatet duhet të zgjidhen në përputhje me DIN EN 206. Në përgjithësi, të gjitha rërat natyrale dhe zhavorret, gurët e thërrmuar apo produktet e tjera të cilët janë provuar më parë në praktikë mund të përdoren si aggregatë me kusht që të jenë plotësuar kërkuesat e specifikuara. Agregatet nuk duhet të përbajnë ndonjë substancë që mund të neutralizojë alkalinitetin e betonit.

### Aditivët

Aditivët për beton duhet të jenë në përputhje me DIN EN 206-2. Aditivët super plastikë do të vijnë nga i njëjtë prodhues si përzierjet e tjera, apo do të jenë të certifikuara për të qenë në përputhje me të gjitha përzierjet

## ARMIMI

### Shufrat e hekurit

Sipas ENV 10080 shufrat e armimit do të jenë prej çeliku me rezistencë karakteristike në terjeqje prej 500 N / mm<sup>2</sup> dhe me një diametër minimal prej 8mm. (BST 500 S sipas DIN 488).

### Rrjetat (zgarat) e salduara

Sipas ENV 10080 zgarat duhet të jenë prej çeliku me rezistencë karakteristike në terjeqje prej 500 N / mm<sup>2</sup>. Ato duhet të jenë në formën e rrjetave të salduara elektrikisht (BST 500 M sipas DIN 488). Përmasat e rrjetave për ndërtimin e përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur tregohet ndryshe, do të jenë 20 X 20 cm dhe me diametër të shufrave 10 mm.

### Telat lidhës

Telat lidhës duhet të jenë tela të forcuar të zinj me diametër 2.2 mm in diameter.

### Bashkimet (xhuntem) e shufrave të armimit

Bashkimet e shufrave të armimit do të bëhen duke kaluar mbi njëra-tjetren në një gjatësi jo më pak se 40 diametra, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe. Ngjitet apo bashkimet e shufrave të armimit duhet të kryhen vetëm sipas vizatimeve përkatëse ose pas miratimit të posaçëm nga ana e inxhinierit mbikëqyrës. Gjatësia e mbivendosjes nuk duhet të jetë më pak se ajo e treguar në vizatimet e projektit.

### Gjatësia e mbivendosjes të zgarave të armimit

Gjatësia e mbivendosjes të zgarave të armimit është minimumi 15 cm në çdo anë, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe.

### Shtresa e betonit mbi armaturë

Shtresa e betonit është trashësia minimale ndërmjet armaturës dhe fakes së betonit.

Shtresa minimale e mbulimit do të jetë sipas normave të KTZ.

Shtresa minimale e betonit do të jetë si vijon:

- Anët dhe fundi i plintave të derdhur mbi sipërfaqen e tokës: 50 mm
- Betoni e ekspozuar ndaj motit: 35 mm
- Betoni i paekspozuar ndaj motit: 30 mm

Përdorimi i distancatorëve është jashtëzakonisht i këshillueshëm për të ruajtur distancat e mësipërme.

### Shtresa sipërfaqësore


Shtresat sipërfaqësore janë pjesë e konstruksionit të shtrimit të trotuareve dhe rrugëve pedonale që vendosen në sipërfaqe të saj sipër shtresave të bazës. Ato duhet të vendosen sipas përmasave dhe paketës së përcaktuara në projekt dhe në përputhje me këto kushte teknike.

### Shtresa me gur natyror (kalldrëm)

Shtresa me guri natyral (kalldrëm) për rrugët dhe sheshet dhe shtresa me pllaka guri për trotuarin.

#### A.Shtrimi i rrugëve dhe shesheve të aksesueshme nga mjetet


Shtrimii trupit të rrugës dhe shesheve të aksesueshme nga mjetet do ketë si shtresë siperfaqësore një shtresë me guri natyror (kalldrëm), me trashësi  $t=8$  cm, e cila do vendoset mbi një shtresë paketë që konsiston në një shtresë niveluese prjej llaç çimento  $t=4$  cm, e cila shërben për fiksimin e pllakave dhe aplikohet mbi një shtresë betoni (C20/25) me trashësi  $t=10$  cm, të armuar zgarë hekuri  $\varnothing 10$  (20x20cm). Shtresa e betonit aplikohet mbi shtresë baze me stabilizant  $t=15$  cm dhe shtresë nënbase me çakell prej 20cm si në figurën nr 1.



— Figura 1 – paketa tip e shtresave të rrugëve dhe shesheve të aksesueshme nga mjetet

#### B.Shtrimi i shesheve për këmbësorët


Sheshet e këmbësorëve, do të shتروhen me pllaka guri me trashësi maksimale  $t=8$  cm që do shتروhet mbi një shtresë absorbuese rëre të imët me trashësi  $t=5$  cm. Kjo shtresë rëre do te aplikohet mbi shtresë baze me stabilizant  $t=15$  cm dhe shtresë nënbase me çakell prej 20cm si në figurën nr 2



— Figura 2 – paketa e shtresave tip të shtrimit të shesheve të këmbësorëve

#### C.Shtrimi i Trotuareve

Trotuaret do të shتروhen me pllaka guri me trashësi maksimale  $t=6$  cm që do shتروhet mbi një shtresë absorbuese rëre të imët me trashësi  $t=5$  cm. Kjo shtresë rëre do te aplikohet mbi shtresë baze me stabilizant  $t=15$  cm dhe shtresë nënbase me çakell prej 20cm si në figurën nr 3.




— Figura 3 – paketa e shtresave tip të trotuarit

Karakteristikat e gurit natyror te shtrimit dhe bordurave

Billoqet e gurit natyror, duhet të jenë në përputhje me sandardin dhe normat e EN 1341: 2000 “për pllaka prej guri natyror për shtresa të jashtme”

Shtrimi do të bëhet me të njejtin kompozicion sipas teksturës së dhënë në projektin arkitekturik. Ky shtrim eshte ilustruar në figurën e mëposhtme (figura 4):



— Figura 4 - Menyra e shtrimit të kalldrëmit në rrugë

Gurët që do përdoren për shtrim, duhet të jenë te prerë me sharrë sipas dimensioneve të dhëna në projekt dhe sipas konfigurimit të propozuar. Siperfaqja e sipërme e gurit duhet të jetë e gdhëndur dhe e skalitur me dorë

— **Gurët për shtrim duhet të përbushin kërkesat dhe karakteristikat fiziko-mekanike si me poshtë vijon:**

- Rezistenza në shtypje para cikleve të ngrirje/ shkrirjes: Minimumi 85 MPa, si mesatarja e testimeve të mostrës për njësi më pak se 80 MPa.
- Rezistenza në shtypje pas 14 cikleve ngrirje/ shkrirje: minimumi 80 MPa, si mesatarja e testimeve të mostrës për njësi më pak se 75 MPa.
- Absorbimi i ujit: maksimumi 4% i mesatares e mostrës për njësi Jo më të madhe se 6%.
- Rezistenza ngrirje / shkrije: Njësitë nuk duhet të kenë thyerje dhe nuk duhet të kenë humbje më tepër se maskimumi 1% të peshës së thatë për çdo shtresë përkatëse që i nënshtrohet 50 cikleve të ngrirjes dhe shkrirjes.

Trashësia e blloqeve prej guri nuk duhet të jetë më pak se 80 mm për shtrimin e rrugës dhe 60mm për shtrimin e trotuarit.

Toleranca e përmasave: ndrysheshmëria në përmasimin e dimensioneve të pllakave të gurit nuk duhet të kalojë me tepër se 1.5 mm në gjatësi dhe 3mm në gjërsi në raport me dimensionet standarde të pllakave.



— Figura 5 – Shembull pllakash guri per shtrim kalldrëmi

### Shtresë niveluese llaç-cimento

Një shtresë niveluese llaçi cimentoje do të vendoset mbi sipërfaqen se përgatitur dhe do të do ketë një trashësi prej 40 mm në mënyrë që të përballojë nivelin e duhur të trotuarit pas vendosjes së shtresës segmentore të bllokut të gurit. Llaçi i cimentos për shtratin duhet të vendoset menjëherë para se të vendosen blloqet e shtrimit të gurit.

### Metoda e shtrimit segmental te gurit

Modeli për shtrimin segmental me gurë, do bëhet në përputhje me detajet e dhëna në projekt dhe në përputhje me udhëzimet e mbikëqyrësit të punimeve. Si fillim duhen shtruar blloqet e plota dhe të padëmtuara, dhe pastaj shtrimi vijon me copat e vogla mbushëse.

Copat e vogla mbushëse duhet të jenë të sharruara ose të prera me kujdes në mënyre që të përshtaten sa më mirë me hapësirë që mbushin. Në rastet kur ka hapësira apo boshillëqe më pak se 20% të përmaseve të një blloku të plotë, ato mund të mbushen me beton 25 MPa.

Fugat ndërmjet blloqeve duhet të jetë ndërmjet 4 dhe 8 mm. Faqet e sipërme të blloqeve duhet të jetë të rrafshëta.

Pasi bëhet shtrimi i blloqeve ne rastin e shtrimit në rrugë dhe ne trotuaret tipi 2, bëhet dhe ngjeshja e tyre me makineri dore në mënyre që të arrihet një kompaktësim sa më i mirë i shtresës. Pasi bëhet ngjeshja e përshkruar më sipër, mbi shtresën e kompakësuar hidhet një

shtrese rëre e imët e cila shpërndahet me fshesë derisa të mbushen të gjitha boshllëqet dhe fugat ndërmjet pllakave të shtruara të gurit.

Çdo tepricë rëre do të hiqet dhe pastrohet dhe më pas trotuari duhet t'i nënshtrohet dy fazave të tjera ngjeshese me makineri ngjeshëse (kompaktor), i cili duhet të punojë në një frekuencë prej 65 - 100 Hz me amplitudë të ulët. Sipërfaqja e ushtrimit të ngjeshjes (pjata) do të jetë 0,2 - 0,4 m<sup>2</sup> dhe do të zhvillojë një forcë centrifugale prej 7 - 16 kN. Në çdo zonë ku mbushësi i fugave (rëra) është nën sipërfaqen e shtrimit, duhet bërë përhapja dhe fshirja me aplikimin e mëtejshëm me rërë të thatë para se të hiqet sasia e rërërave të tepërtë.

### **Menyra e matjes dhe pageses**

Pagesa për punën e përcaktuar në këtë seksion të Specifikimeve teknike për një shtresë të segmentale shtrimin bllok gur do të bëhet për metër katror të shtrimit të rrugës apo trotuarit sipas llojit te shtrimit (tipi 1 apo tipi 2) në përputhje me zërat e preventivit të kontratës shtresën e gurit përfshirë llaç çimento për shtrat shtresë guri ne trotuar tipi 1 ,dhe shtren e rërës në rastin e shtrimit të rruges dhe të trotuarit të tipit 2.

Pagesa për zërat në fjale përfshin furnizimin e materialeve, ngarkimin, transportimin, nivelimin, shtresën llaç çimento (per trotuarin tipi 1), shtresen e reres , sigurimin e këndeve dhe buzëve të trotuarit, vendosjen e bloqeve të gurit, duke përfshirë prerjen axhustimin, mbushjen e fugave, ngjeshjen, mbushjen dhe dhe largimin e materialeve të panevojshme jashtë kantierit në përputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor.

### **Bordurat e gurit**

Bordurat e gurit duhet të plotësojnë standardet EN 1343:2000 "bordura prej guri natyror për shtrime të jashtme".

Bordurat e gurit që do përdoren për trotuaret, duhet të jenë te prera me sharrë sipas dimensioneve të dhëna në projekt.

### **Bordurat e gurit duhet të përbushin kërkesat dhe karakteristikat fiziko-mekanike si me poshtë vijon:**

- Rezistenza në shtypje para cikleve të ngrirje/ shkrirjes: Minimumi 85 MPa, si mesatarja e testimeve të mostrës për njësi më pak se 80 MPa.
- Rezistenza në shtypje pas 14 cikleve ngrirje/ shkrirje: minimumi 80 MPa, si mesatarja e testimeve të mostrës për njësi më pak se 75 MPa.
- Absorbimi i ujit: maksimumi 4% i mesatares e mostrës për njësi Jo më të madhe se 6%.
- Rezistenza ngrirje / shkrije: Njësitë nuk duhet të kenë thyerje dhe nuk duhet të kenë humbje më tepër se maskimumi 1% të peshës së thatë për çdo shtresë përkatëse që i nënshtrohet 50 cikleve të ngrirjes dhe shkrirjes.



– *Figura 6– Shembull bordurash guri të prera me sharre*

### **Instalimi**

Billoqet e bordurave duhet të instalohen para hedhjes së dyshemeve të trotuarëve. Një kanal duhet hapur në terren me dimensionet e kërkuara. Kanali duhet të jetë të paktën 10 cm më i gjërë se blloqet, në të dy anët. Blloqet vendosen përsipër betonit gjysëm të thatë të derdhur përgjatë kanalit. Beton duhet të derdhet më pas në të dy anët në mënyrë që të fiksohen bordurat.

Përgjatë pjesëve të drejta gurët e bordurave ose të kunetave vendosen me ndihmën e një fijeje drejtuese. Toleranca e linjës aktuale (sipas faktit) në krahasim me vijën ideale (siç tregohet në projekt), duhet të jetë jo më shumë se 1 cm. Devijimi maksimal të bordurës se gurit në krahasim me linjën aktuale duhet të jetë jo më shumë se 0.5 cm. Parregullsitë (shtrembërimet) nuk mund të jetë më të mëdha se 4 mm.

Bordurat e tranzitit për lejimin e kalimtarëve që janë vendosur midis bordurave të llojeve të ndryshme dhe me lartësi të ndryshme duhet tëjenë të pjerrëta, d.m.th. lartësia e bordurës në lidhje me rrugën ose me pjesën e kullimit rritet apo zvogëlohet gradualisht drejt bordurave të tranzitit. Bordurat e të gjitha llojeve gjithmonë duhet të vendosen mbi një themel dhe duhet të mbështeten me beton të varfër në anën e pasme.

Fugat e nyjeve janë të vendosura vertikalisht dhe në kënd të drejtë me aksin e rrugës. Gurët e bordurave vendosen direkt pranë njëri-tjetrit dhe fugat e tyre nuk mbushen me llaç. Bordurat duhet të kenë fuga jo më të gjera se 6 mm:

Fugat midis pjesëve të ulluqeve të bordurave të kullimit, si edhe të gjitha fugat midis bordurave të kullimit duhet tëjenë të mbushura me llaç ose me mbushës plastik.

Llaçi duhet të jetë i përbërë nga rërë, çimento dhe / ose gëlqere, përzierje uji, dhe mundësisht një përbërje që vonon stazhionimin ose një agjent që çon në rritjen e porozitetit brenda betonit.

Sasia e çimentos ose gëlqeres duhet të jetë të paktën 450 kg / m<sup>3</sup> rërë.

Gjatësia e bordurave që duhet të sharrohen për tu adoptuar sipas vendit duhet të jetë të paktën 0.5 m.

### **3. SPECIFIKIME TEKNIKE - Projekti Konstruktiv**

**Specifikimet teknike të objekteve të projektit “Projekt rikualifikimi ne zonen urbane prane qendres se qytetit Vlore : Hartimi i projektit urban, Restaurimi i monumenteve te kultures ne kete zone dhe Rikonstruksioni i objekteve te tjere.”**

#### **Specifikime teknike të materialeve që do të përdoren për konsolidim**

Materialet të cilat do të përdoren për konsolidimin e objekteve, do të jenë në përputhje me specifikimet teknike europiane.

#### **Druri**

Elementët që do të vlerësohen se nuk plotsojnë kushtet e nevojshme karshi rezistencës dhe ngurtësisë së nevojshme për elementët strukturorë, do të zëvendësohen me lëndë të re. Druri që do të vendoset i ri në të gjithë ndërhyrjet konsoliduese, duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

Markuar me markën CE sipas EN 14081.

Klasa e Rezistences C22 sipas EN 338.

Përqindja e lagështisë së elementeve më pak se 18%.

Tolerancat në dimensione konform EN 336.

Në rast se nga vlerësimi i kryer, rezulton që elementët strukturorë plotësojnë ende kushtet e rezistencës mekanike, ngurtësisë dhe qëndrushmërisë, atëherë do të bëhet konsolidimi i tyre sipas metodave standarte të përshkruara më poshtë:

UNI 11118- Trashëgimia kulturore- Elementët e drurit- Kritere për identifikimin e llojeve të drurëve.

UNI 11119- Trashëgimia kulturore- Elementët e drurit- Strukturat mbajtëse të ndërtesave- Inspektimi in-situ për diagnozën e elementeve në vepër.

UNI 11130- Trashëgimia kulturore- Elementët e drurit- Terminologja e degradimit të drurit.

UNI 11138- Trashëgimia kulturore- Elementët e drurit- Strukturat mbajtëse të ndërtesave. Kritere për vlerësimin preventiv, projektimin dhe ndërhyrjet .

UNI 11161- Trashëgimia kulturore- Elementët e drurit- Udhëzues për konservimin, restaurimin dhe mirëmbajtjen.

#### **Muratura**

Muratura e re që do të ndërtohet duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme themelore për ndërtimë në zona sizmike:

- Rezistencën karakteristike në shtypje në drejtimin mbajtës  $f_{bk}$  jo më të vogël se 5 MPa, llogaritur në sipërfaqen neto (hequr brimat, të cilat në këtë rast nuk janë prezent).
- Rezistencën karakteristike në shtypje në drejtimin pingul me atë mbajtës, në planin e murit ( $f_{bk}$ ), të llogaritur në të njëjtën mënyrë si më sipër, jo më tepër se 1.5 MPa

Gjithashtu, muratura duhet të plotësojë edhe kërkesat bazë të përcaktuara nga EK 6:

- EN 1996-1-2 (2005) EUROPACODI 6– Projektimi i strukturave të muraturës- Pjesa 1:

Rregulla të përgjithshme

- EN 1996-2 (2006) EUROKODI 6- Projektimi i strukturave të muraturës- Pjesa 2:

Konsiderata në projektim, zgjedhja e materialeve dhe zbatimi i muraturës.

*Muratura e gurit-* të ndërtohet me materialin original (gurë të skuadruar të ndërthurur) i cili të përcaktohet duke analizuar materialin ekzistues në vend, karakteristikat fizike, mekanike dhe gjimeometrike të elementeve rezistues natyralë.

Muratura e gurit nuk duhet të jetë e thërrmueshme, të mos këtë praninë e mbetjeve organike ose substancave të tretshme, të mos ketë pjesë të cilat mund të shkëputen ose të jenë të ndryshme nga masivi, të ketë aftësi ngjitetë shumë të mirë me llaçin.

Gjithashtu muratura duhet të plotësojë kushtet për durabilitetin optimal (qëndrueshmërinë ndaj ngricave, qëndrueshmërinë ndaj efloreshencës, të mos jetë e ndjeshme ndaj kapilaritetit, mungesën e mikrofrakturave).

*Muratura e tullës-* Muratura e tullës të ndërtohet me materialin original (tullë e plotë) i cili të përcaktohet duke analizuar materialin ekzistues në vend, karakteristikat fizike, mekanike dhe gjimeometrike të elementeve artificialë.

*Llaçi-* Për përdorimin në muraturë mbajtëse pranohet vetëm përdorimi i llaçeve me rezistencë  $f_m \geq 2,5 \text{ N/mm}^2$ . Në varësi të përfundimit që do të arrihet pas analizimit të llaçit original, të bëhet gatitja e llaçit që do të përdoret sipas tabelës së mëposhtme:

Klasa	Lloji i llaçit	Përbërja				
		Çimento	Gëlqere ajoore	Gëlqere hidraulike	Rërë	Pucolanë
M 2.5 (N/mm <sup>2</sup> )	Hidraulik			1	3	
M 2.5(N/mm <sup>2</sup> )	Pucolanik		1			3
M 2.5(N/mm <sup>2</sup> )	Bastard	1		2	9	
M. 5(N/mm <sup>2</sup> )	Bastard	1		1	5	
M.8 (N/mm <sup>2</sup> )	Çimento	2		1	8	
M. 12(N/mm <sup>2</sup> )	Çimento	1			3	

Tab.4.10 Dozatura per prodhimin e llaçit

### Celiku

Markuar me markën CE sipas EN 10025:2004

Celiku strukturor që do të përdoret do të jetë me karakteristikat:

Klasa S275 sipas EN 10025-2

Pesha volumore  $\gamma=78.5 \text{ kN/m}^3$ .

Moduli i elasticitetit  $E=2.1 \times 10^8 \text{ kN/m}^3$ .

Kufiri i rrjedhshmërisë  $f_y=275000 \text{ kN/m}^2$  për spesor nominal të pllakave  $t \leq 40\text{mm}$  dhe  $f_y=235000 \text{ kN/m}^2$  për spesor nominal të pllakave  $40\text{mm} \leq t \leq 80\text{mm}$

Kufiri i soliditetit  $f_u=430000 \text{ kN/m}^2$  për spesor nominal të pllakave  $t \leq 40\text{mm}$  dhe  $f_u=410000 \text{ kN/m}^2$  për spesor nominal të pllakave  $40\text{mm} \leq t \leq 80\text{mm}$ .

### **Beton I armuar**

Betoni markuar me markën CE sipas EN 206-1

Klasa e Rezistences C 20/25

Pesha volumore  $\gamma=78.5 \text{ kN/m}^3$ .

Moduli i elasticitetit  $E=0.29 \times 108 \text{ kN/m}^3$ .

Rezistenca karakteristike cilindrike  $f_{ck}=20\,000 \text{ kN/m}^2$ .

### *Armatura e çelikut*

Markuar me markën CE sipas EN 10080

Klasa e Rezistences S500.

Kufiri i rrjedhshmërisë së armaturës në përkulje  $f_{yk}=500\,000 \text{ kN/m}^2$ .

Kufiri i rrjedhshmërisë së armaturës në prerje  $f_{yek}=400\,000 \text{ kN/m}^2$ .

### **Specifikime teknike të nderhyrjeve konstruktive per konsolidimin e objekteve.**

Specifikimet teknike do jene ne perputhje me Kushtin Teknik Shqiptar per Zbatimin e Punimeve si dhe në përputhje me specifikimet teknike europiane.

### **Specifikimi teknik per injeksionet lokale:**

1. Ne rast se hundenza e injektimit nuk futet drejtperdrejt ne plasje, eshte i nevojshem shpimi me trapano me rrotullim (diameter 14 mm) ne trasene e plasjes. Ne rast se plasaritia do te evidentohet ne te dy anet, brimat do te behen ne te dy anet e muratures. Brimat do te kene thellesi qe varion nga trashesa e muratures, ndersa thellesia minimale e tyre eshte 20 cm. Largesia maksimale midis brimave te injektimit te merret 40 cm.
2. Futen hundezat ne secilen nga brimat, ne një thellesi prej reth 5 cm.
3. Stukimi i plasjeve ose xhuntove te degraduara nga jashte, me te njejtin llaç qe do te kryhet injektimi ose ne rast se kjo nuk eshte e mundur me një llaç me ngurtesim te shpejte.
4. Pergatitja e misheles qe do te injektohet me trapano dhe furçë dhe me pas injektimi i misheles ne murature duke filluar nga brimat e poshtme e duke vazhduar ne brimat e siperme.
5. Ne rast se muratura ne brendesi eshte e mbushur me material te palidhur dhe ka boshlleqe, atehere per kursim te materialit dhe shmangje te mbi-forcimit lokal te muratures te aplikohet llaç jo-shume fluid.

### **Specifikimi teknik per konsolidimin e themeleve:**

Konsolidimi i themeleve do te kryhet sipas etapave te meposhtme:

1. Paraprakisht kryhet sondazhi i themelit per te verifikuar permasat.
2. Hapet themeli ne te dy anet, me seksione me gjatesi te kufizuar (1.5m).

3. Instalohen me injektim ne trupin e themelit ankera çelik-inoks, ne te dyanet. Njekohesht, çdo 1.5m realizohet njelidhje me travet terthor.

4. Instalohen ne te dy anet e themelit breza perfocues me hekur gjatesor dhe stafa.

\*\*Shenim : Perpara miratimit te zgjidhjes perfundimtare, te sigurohet nga porositesi reporti gjeologjik perkates.




Fig. 4.153 Detaj i konsolidimit nepermjet zgjerimit te themelit.

#### Specifikimi teknik per konsolidimin e kornizave te shkeputura:

Konsolidimi i elementit dekorativ do te behet me shufra bronzi qe konvergjojne ne nje pike, sipas hapave te meposhtme:

1. Hapen paraprakisht me trapano me rrotullim te pakten tre brima konvergjente per çdo shkeputje.
2. Montohen shufrat e bronxit duke lene te lire pjesen hyrese te vrimave.
3. Stukohet pjesa e hyrjes me stuko me ngjyre te ngjashme me ate te dekorit.
4. Ne rast se vrimat nuk do te hapen nga ana e fasades (tejpertej), atehere elementi te fiksohet vetem nga ana e brendshme.



Fig. 4.154 Detaj i konsolidimit te kornizave.

#### Specifikimi teknik per konsolidimin e çatise nepermjet tirantave metalike:

Aplikimi i tirantave ne konsolidimin e mbuleses do te kryhet sipas etapave te meposhtme:

